
Kolonializmi absurd	3
Olajuwon refuzon akuzat e bëra ndaj tij	5
Sekularizmi dhe feja në perëndim	6
Mësim-besimi nëpër shkolla.....	9
Koncepti i dashurisë.....	11
Djaloshi dhe mbreti	15
Kërkimi i të vërtetës, fuqisë dhe qëllimit	18
Kape të sotmen, e nesërmja nuk është e jotja	22
Kalendari i hixhretit	24
Përfundimi i vitit dhe përfundimi i ymrit	27
Para se të përmytet barka	35
Hyrje në shkencat e Kur'anit	39
Besimi në Ditën e Gjykimit	42
Hadithi: Dy fjalët e lehta në gjuhë	44
Gruaja jote është e gjithë bota për ty	46
Këshilla të vogla për një kurim të madh.....	48
“...dhe mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre...”	49
Imam Es Sefarini.....	51
Ibën Ahmed el Hakemi	52
Imam Esh Shatibi.....	54
Imam Ed Darekutni.....	55
Tema: Fëmija i adoptuar	57
Pozita e sunnetit në Islam (1)	58
20. Heshtja dhe ruajtja e gjuhës.....	60

edicion i botuar / viti i dytë / nr: 20

www.albislam.com

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

albislam@albislam.com

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi,
Alajdin Idriz, Fatmir Zaimi

str: 386 no: 11 lokal: 44, 1000 Shkup
fax: +389 2 3290 408

Del çdo muaj lunar. Takvimi i Türkiye Diyanet Vakfi. Numri i ardhshëm: 10 04 2005

Boton: NUN-R DOOEL

Xhironlogaria: 300000001759616 Komercijalna Banka A.D.- Skopje Numri tatimor:4030003487017

Regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2.

Kolonializmi absurd

Më falni për gjuhën joprofesionale por vendimi i marrë nga këshilli qeveritar i Irakut për ta bërë 9 prillin, ditën e re të festës kombëtare është me të vërtetë budallallëk. Kolonialistët në përgjithësi janë budallenj. Kolonializmi është i bazuar mbi mos shfaqjen e qëllimit të tyre, verbëria është komponenti strukturor i kolonializmit, padronët kolonialistë e shikojnë Afrikën por jo afrikanët, e shikojnë Palestinë por jo palestinezët, e shohin Irakun por jo irakenët. Megjithatë, budallallëku amerikan në Irak është si shumë gjëra të tjera amerikane i ekzagjeruar.

Kur Napoleoni së pari erdhi në Kajro, ai së pari ai ndoqi hilen amerikane për ta bërë pushtimin të duket sikurse ishte një çlirim. Në një pamflet të shpërndarë në Aleksandri një ditë përpara se të binte qyteti në duart e trupave franceze, përkthyesit e Napoleonit futën shprehjen “el-Ummah el-Misrije” (populli egjiptian ose kombi egjiptian) për herë të parë në gjuhën arabe. Napoleoni doli me thirrjen se ishte duke i çliruar egjiptianët nga Mamlukët, të cilët ishin të huaj, ai ishte një çlirimtarë dhe jo një pushtues. Sigurisht, njerëzit e Kairos, Mamlukët dhe Osmanët nuk ishin të huaj, islami dhe jo nacionalizmi ishin bazat e identitetit politik. “El-Ummah el-Islamijje” (Populli mysliman) ishte i vetmi popull rreth e rrotull veçanërisht kur vinte puna në qëndrimet ndaj Evropës.

Napoleoni u tregua i shpejt në ndryshimin e mendimit pasi e kuptoi që kjo nuk do të ecte, kështu ndryshoi diskutimin e tij. Në

mënyrë për t’ju shmangur krahasimit me kryqëzatat, ai vazhdonte të deklaronte se nuk ishte i krishterë dhe këtë e argumentoi se kishte sulmuar fronin e Papës së Romës. Në takimin e tij me njerëz të dalluar të Kairos dhe dijetarë myslimanë të el-Azharit në korrik 1798, ai doli me thirrjen se vetë ishte musliman. Oficerët francez u urdhëruan të mos i sulmonin gratë, të mos pinin alkool në vende publike dhe të mos hynin nëpër xhamia. Ai vendosi një këshillë qeverisë, tamam sikurse ky i Paul Bremerit që është i vendosur në Irak. Katërmëdhjetë dijetarë të el-Azharit ishin tani qeveria administruese e qeverisë së Egjiptit nën pushtimin francez. Nivelet e tyre të gjithë filluan të deklararin se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij. Ai madje e bëri këshillin e katërmëdhjetëshes të nxjerrë një fetva (një verdikt fetar) duke thënë që Napoleoni ishte Mehdiu, një figurë fetare, paraqitjen e së cilës, myslimanët e besojnë, do ta mbushë vendin me drejtësi ashtu siç ka qenë e mbushur me shtypje. Ata dolën me thirrjen se 20 ajete kur’anore të Kuranit i referoheshin Napoleonit!

Nuk shkoi shumë dhe egjiptianët dolën me një përgjigje të këtij budallallëku. Pas dy muajsh, Kairoja po digjej nga flota franceze. Dijetarët e rinj të el-Azharit deklaruan luftë, duke u ankuar që hoxhallarët të cilët mbështetën Napoleonin janë bërë francez dhe si rezultat nuk konsideroheshin më si musliman (një lëvizje kjo që ishte shumë e

efektshme në bindjen e shumë prej katërbëdhjetë dijetarëve të rishqyrtonin lidhjet e tyre politike dhe të bashkoheshin me revoltën). Sidoqoftë pushtuesit ishin pushtues, dhe ata nuk kishin asnjë të drejtë të qeverisnin myslimanët, kjo ishte një kryqëzatë e re dhe Napoleoni përkundër deklarimeve të tij të vazhdueshme nuk ishte më i ndryshëm sesa Luisi IX dhe ai nuk meritonte fat tjetër më të mirë (Luis IX ishte ngujuar në shtëpinë e një gjyqtari dhe rrihej më një shkop të trashë çdo ditë, që kur ishte kthyer në Francë).

Diskurset koloniale të anglezëve pas luftës së parë botërore nuk ishin më të ndryshme. Ata dolën me thirrjen se janë duke i shpëtuar njerëzit e Lindjes së Mesme nga tirania e pushtetarëve turq, të cilët ata anglezët vendosën që ata ishin të huaj në rajon. Skema nuk eci as kësaj here dhe shumë gjak duhej të derdhej në Egjipt, Palestinë dhe Irak vetëm e vetëm që të merrnin këtë mesazh: “Ne ju urrejmë ju dhe ne ju dum jashtë vendeve tona”.

Megjithëse, masat e këtyre francezëve dhe anglezëve ishin të kota, politikat amerikane në Irak janë edhe më të këqija. Sulmi i i civilëve irakenë ka filluar që dhjetë vite

përpara pushtimit. Vrasjes në masë të irakenëve nga armët e padukshme të shkatërrimit në masë e quajtur embargo nuk kanë lënë ndjenja në zemrat e irakenëve. Pastaj, menjëherë pas pushtimit, përsëri vrasje civile, kërkimet e shtëpive, zbulimet e grave dhe shumë poshtërime të tjera.

“Lufta kundër terrorizmit” është kthyer në një luftë ndjenjash, çdo simpati për islam është e parë si një rrezik politik që është dëshmuar në shumë fjalë. Hapi i parë i amerikanëve që ishte “sjellja e demokracisë në Irak” ishte shtyrja e zgjedhjeve në pafundësi, vetëm për shkak se zgjedhjet nuk i përshtaten atyre. Tani kjo deklaratë e këshillit qeveritar që 9 prilli, dita që Bagdadi ra, të quhej ditë kombëtare, është budallallëk, qesharak dhe i kotë, sikurse ishte deklaratata e 14 dijetarëve që thanë se Napoleoni ishte Mehdi. Vetëm këtë herë, madje edhe hapat e kujdesshëm të marra nga Napoleoni dhe Anglezët nuk shihen. Kur Napoleoni deklaroi se ishte Mehdi ai nuk ishte masakruar njerëzit e Kairos ende, masakra erdhi më vonë.

Pushtimi amerikan i Irakut nuk është vetëm pos një kthim tek një kohë klasike kolonializmi...

Tamim Barguti
Marrë nga: The Daily Star Lebanon
Përktheu: Ammar Abdul Xhelil
11.2.2005

Olajuwon refuzon akuzat e bëra ndaj tij

Basketbollisti i dikurshëm i NBA-së, Ha-keem Olajuwon ka thënë para disa ditëve se kontributet financiare që janë dhuruar nga xhamia e tij kanë pasur për qëllim organizatat bamirëse që merren me aktivitete humanitare. Ai ka shtuar se kur janë dhënë kontributet, nuk ka pasur mundësi të dihet se grupet që i kanë marrë donacionet kanë lidhje me terrorizmin.

Olajuwon i përgjigjeshte një raport i publikuar javën e kaluar nga agjencia amerikane e lajmeve Associated Press ku thuhej se Qendra Islame Da'wah në Houston ka dhuruar më shumë se 80 mijë dollarë organizatave bamirëse që qeveria amerikane më vonë i ka akuzuar se kanë lidhje me Al Qaeda dhe me grupe tjera terroriste.

Olajuwon, i cili u pensionua në vitin 2002, pas 17 stinorëve të kaluara në ekipin Houston Rockets dhe një stinor me Toronto Raptors, momentalisht gjendet në Jordan ku studion gjuhën arabe.

“Më duheshte një karrierë e tërë ta krijoj emrin tim dhe t'i përkrah kauzat të cilat i kam zgjedhur. Është vështirë të pranoj se emri im tani lidhet me terrorizëm”, ka thënë Olajuwon gjatë një tele-konference 40 minutëshe të inicuar nga ai, nga kryeqyteti jordanez.

Sipas raportit të AP-së që u publikua më 9 shkurt të këtij viti, xhamia e tij ka dhuruar 61.250 dollarë në vitin 2000, 20 mijë dollarë në vitin 2002 organizatës Islamike afrikane, ndërsa 2.430 dollarë në vitin 2000 Fondacionit për Ndhim dhe Zhvillim në Tokën e Shenjtë.

Raporti i AP-së po ashtu njofton se qeveria amerikane në muajin tetor ka mbyllur organizatën islamike afrikane, duke e akuzuar atë se ka financuar Osama bin Ladenin dhe Al Qaeda, ndërsa në vitin 2001 ajo ka mbyllur Fondacionin për Ndhim dhe Zhvillim në Tokën e Shenjtë.

42 vjeçari Olajuwon, i lindur në Nigeri dhe i konvertuar në Islam, ka insistuar se ai nuk ka njohuri për çfarëdo lidhje që organizatat bamirëse kanë pasur me terrorizmin. Nëse e kisha dikur, nuk do të kisha lejuar që xhamia të jep ndihma, ka shtuar ai.

“Në kohën kur i dhamë ndihmat në vitin 2002, ne nuk dinim asgjë rreth terroristëve”, ka thënë ai. “Nuk kishte ndonjë arsye të dyshojmë se organizatat bamirëse kanë lidhje me terroristët” dhe ka theksuar se “Fondacioni për Ndhim dhe Zhvillim në Tokën e Shenjtë ka qenë organizatë jo-profitabile me seli në Sh.B.A. dhe e regjistruar në Shërbimet e Brendshme të të Ardhurave (I.R.S.). Ndërsa për donacionet e xhamisë ai ka thënë se janë raportuar rregullisht pranë IRS-së.

“Kjo nuk ishte një gjë e fshehtë. Ishte mjaft e hapur. Ishte e qartë. Kjo nuk ishte një gjë e llojit, të themi, të nëntokës. Ishte qartë një donacion për organizata humanitare”, ka thënë Olajuwon.

Ai poashtu ka thënë se Fondacioni për Ndhim dhe Zhvillim në Tokën e Shenjtë, ka kërkuar përkrahje nga xhamia për një program për ndihmë bonjakëve.

“Puna e tyre shihet, dokumentet e tyre shihen, me ato aktivitete ata janë marrë vite

me radhë dhe ata kanë pasur leje nga qeveria. Jo vetëm tek ne, por ata shkojnë nëpër komunitete të ndryshme për të marrë ndihma, për shkak se kanë leje”, ka thënë Olajuwon.

Olajuwon ka thënë se xhamia duhet të bëjë kontrolle më të hollësishme të organizatave bamirëse para se të jep donacione. Ai ka thënë poashtu se është befasuar që raporti fillestar është bërë lajm ndërkombëtar. I shqetësuar ai ka thënë se “një artikull

që më ka lidhur me një grup terrorist” është botuar në Nigeri. “E kemi për detyrë që si miq, raportet t’i transmetojmë sinqerisht”.

Ai ka argumentuar se raporti i AP-së ishte i çorientuar dhe se faktet i janë nxjerrë nga konteksti.

Olajuwon, që është qytetar amerikan, ka thënë se është i brengosur se si do ta shohin njerëzit kur do të kthehet në Sh.B.A pas disa muajve. Ai e quan veten figurë publike që mundohet t’i “ndihmojë shoqërisë”.

përktheu: xh.a.
DAVID PICKER,
25.2.2005

Çështja e sekularizmit dhe fesë në perëndim

Ai që dëgjon bisedat e laikëve të vendeve myslimane mbi relacionin shtet-fe, politikë-fe sikur e kaplon iluzionin për ndarjen e plotë mes fesë dhe politikës në vendet perëndimore. Ai mbetet i bindur për njëzëshmërinë e perëndimorëve për moton “feja nuk ka çfarë të përzihet në çështjet e shtetit dhe shteti duhet të mbetet laik” si dhe për parullën “feja është çështje personale e çdo individi.” Por nëse fillon të përcjellësh atë që e thuan perëndimorët, në veçanti atë që thuhet në Amerikë, do të shohësh që realiteti është ndryshe asaj që të është përshkruar nga laikët e vendit tënd. Do të shohësh se relacioni shtet-fe është temë rreth të cilës zhvillohen beteja të vërteta, rreth të cilës shkruhet dhe flitet, debatohet dhe bisedohet. Qëndrimet ndaj këtij relacioni shkaktojnë ndarje në grupacione dhe parti. Po të ishin të përkthyer këto debate pa e shpallur vendndodhjen e tyre do të mendo-

je që debate të tilla mundet të ndodhin vetëm në vendet Islame. Ja një shembull:

Para disa vite në një konferencë u takova me një njeri që ishte fetar, krishteri i cili pasi që kuptoi për besimin tim dhe përpikshmërinë në zbatimin e obligimeve fetare më tha: Mos u mashtroni siç u mashtruan ne më sekularizmin. Menduam se është sistemi i cili nuk favorizon asnjë fe që më vonë të kuptojmë se është religjion që armiqëson fetë. Këto fjalë më befasuan mu ashtu siç ndoshta janë befasuar disa lexues të këtij teksti. Në vete thash si mundet që këto fjalë t’i thotë një perëndimor. Rreziku i sekularizmit për fenë krishtere ishte ndjenjë e cila në vitet e fundit u rrit dukshëm. Një profesor i filozofisë, me besim katolik, në vitin 1996 publikoi libër në të cilin vëllezërit e tij të krishterë i këshillon me këto fjalë:

“Prej çështjeve më të rëndësishme të këtij libri është fakti që ne kemi nevojë për

rishqyrtim të kategorizimeve tek ne si dhe për riklasifikimin e forcave. Në fillimisht duhet të jemi të vetëdijshëm për gjendjen e luftës në të cilën jemi si dhe të kuptojmë ndryshimin rrënjësor të palëve në konflikt. Shumë prej armiqve tanë të kamotshëm janë miq të sodit dhe shumë prej miqve tanë, humanistët për shembull, sot i kemi armiqë. (Peter Kreeft, Ecumenical Jihad: Ecumenism and the Culture War, fq.9)

Ashpërsia e fushatës krishtere kundër sekularizmit u rrit gjatë zgjedhjeve amerikane në të cilët Partia Demokratike, nga ana e Partisë Republikane u paraqit si parti laike liberale duke e promovuar vetën (P.Republikane) si parti e cila ndihmon fenë dhe mbron vlerat morale.

Njëri prej tyre në tekstin e tij "Feja kundër sekularizmit" (Religion vs. Secularism in Politics By Paul Strand, Washington Sr. Correspondent) shkruan kështu: "Çështja e fesë është bërë një nga faktorët më të rëndësishëm në përcaktimin e mënyrës së votimit. Ata që më shumë falen anojnë ka Partia Republikane, ndërkohë që ata që nuk falen anojnë kah Partia Demokratike. Sipas një anketës 63% prej atyre që më shumë se dy herë marrin pjesë në ritet fetare janë përcaktuar për P.Republikane, në kohë që 62% prej atyre që nuk marrin pjesë në rite të tilla ose i bëjnë rrallë kanë thënë se do të votojnë për P. Demokratike. Prania e madhe e jofetarëve në P. Demokratike është forcë e cila rrezikon të shndërron partinë në fjalë në parti sekulare. Autori pastaj ankohet nga mediat të cilët potencojnë dominimin e krishterëve fanatikë në Partinë Republikane (Fallwell-i për shembull) në kohë që neglizhojnë dominimin e sekularistëve në P. Demokratike. Pastaj cek rezultatet e hulumtimit nga dy sociologë sipas të cilëve prej vitit 1992, 70-80% prej sekula-

ristëve dhe liberalëve votojnë për kandidatin demokrat ndërkohë që 2/3 të fetarëve tradicionalë votojnë për kandidatin republikan.

Një grua fetare kështu e përshkruan dallimin në votim: Ata që mendojnë në zgjidhjet njerëzore votojnë për demokratët në një kohë që ata që besojnë në zgjidhje hyjnore të problemeve votojnë për republikanët.

Shumica e gazetarëve në Amerikë me lajmet e tyre përkrahin armiqët e besimtarëve. Sipas një anketës një e treta e të angazhuarve në media mendojnë se besimtarët e këtij lloji janë rreziku më i madh për demokracinë, mbi 50% janë kundër forcës së madhe politike që e kanë fetarët. Më pak se gjysma e gazetarëve nuk praktikojnë asnjë besim në kohë që afro 80% shumë rrallë i vizitojnë kishat.

Në muajt e fundit u publikua libri i autorit të njohur krishterë David Limbaugh me titull "Persecution: How Liberals are waging war Against Christianity" "Persekutim: Si e luftojnë liberalët krishterizmit" i cili në pesë javët e para pas botimit ishte libri më i shitur sipas New York Times-it. Në një prej ceremonive fetare ai tha: Ne e përjetojmë luftën kundër kulturës (term me të cilin përcaktojnë besimin dhe vlerat morale). Krishterimi është objektivi i luftës që e zhvillojnë humanistët sekularë. Krishterimi në tërë botën është i rrethuar. Vlerat sekulare mbizotërojnë në vendin tonë. Ky është fakt që ne duhet ta marrim parasysh.

Në mesin e mjeteve të luftës kundër krishterizmit ai përmend largimin e fesë nga sektoret publike.

Nenin e kushtetutës që ndanë fenë nga shteti ai, si jurist, kështu e komenton: Themeluesit e shtetit tanë me këtë nen të kushtetutës nuk synonin ndarjen e shtetit nga feja. Ata këtë nen e vendosën në kushtetutë për të mbrojtur Kongresin dhe qeverinë

federale nga formimi i një kisha të fortë.

Lufta kundër kulturës (besimeve dhe vlerave morale) me të madhe zhvillohet dhe rritet dita ditës në Sh.B.A. Për këtë luftë, shkaqet dhe rreziqet e saj janë shkruar shumë libra dhe punime shkencore. Liberalët dhe tradicionalistët vazhdojnë në akuzimin e njëri tjetrit për rritjen e ashpërsisë të kësaj lufte.

Disa prej tyre thonë: Demokratët janë shkaku i kësaj gjendjeje sepse partisë së tyre i dhanë kahje majtiste. Shumë nga laikët dhe liberalët (që njihen si armiq të fetarëve) janë anëtarë në këtë parti për të cilën disa prej tyre pohojnë: Partia demokratike është parti në të cilën nuk ka vend për Zotin.

Shumë nga krishterët që jetojnë në Evropë, katolikët në veçanti protestuan kundër kushtetutës së re evropiane në të cilën aspak nuk përmendet krishterimi, bile as si element ndikues në formimin e kulturës perëndimore.

Në tetor të vitit 2004 kardinali Joseph Ratzinger (njëri prej kandidatëve për postin e papës) në një prej debateve shprehi frikën e tij nga rritja e sekularizmit në Unionin Evropian:

“Sekularizmi si ideologji e shpikur shpjen drejtë dominimit të parcializmit i cili kur të lirohet në fund do të ndeshet me vetën duke e shkatërruar punën njerëzore.”

“Si arsye për mospërmendjen e krishterimit në kushtetutën e re evropiane përmendet mosprovokimi i myslimanëve. Si përgjigje themi: Ajo që gjithashtu hidhëron Islamin është ofendimi i Zotit dhe arroganca e laikëve që shkaktojnë fundamentalizmin fetar.”

Sipas fjalëve të këtij kardinali sekularizmi është ideologji parciale dhe ai si i tillë nuk mundet t'u përgjigjet sfidave të njerëzimit. Intelekti nuk është armik i besimit. Problemi shkaktohet kur nënçmohen Krijuesi dhe shenjtëritë. Liria sot kuptohet si gjë individuale pa e marrë në konsideratë faktin që njeriu është qenie shoqërore. Liria e përbashkët është liri për të gjithë dhe ajo si e tillë përkufizon lirinë.

Sekularizmi tek disa fetarë perëndimorë konsiderohet si ideologji e cila përkufizon lirinë. Për këtë çështje kryetari i lidhjes së mjekëve të Katalonisë (Spanje) në faqen e tyre të internetit shkruan: Nëse në të kaluarën ne si ideologji shkatërruese përmendnim fashizmin dhe marksizmin sot atë mundemi ta themi edhe për sekularizmin i cili përkufizon lirinë e të shprehurit dhe lirinë e praktikimit të besimit. Si shembull ata përmendën faktin që askush sot nuk mundet të bëhet mjek gjinekolog pa e praktikuar abortin. Lajmërimet e kësaj shoqate në spitalet e Francës ndalohen duke u komentuar si manifestime fetare!

Dr. Xha'fer Shejh Idris
Përktheu: Talha Kurtishi
Dr. Xha'fer Shejh Idris,
25.2.2005

Mësim-besimi nëpër shkolla

Në vazhdim të iniciativës të kryetarit të Republikës së Maqedonisë, për takime të rregullta mes krerëve të bashkësive fetare në Maqedoni, të hënën më 28 02 2005, në një manastir në Shkup u mbajt takimi i dytë punues. Takimi i parë në Ohër u mbajt vjeshtë që kaloi, menjëherë pas referendumit të organizuar kundër ndarjes së re territoriale, kurse ky i tanishmi vjen në prag të zgjedhjeve të reja lokale. Për takimin i cili ishte i mbyllur për gazetarë, kumtesë publiko vetëm nikoqiri i këtij takimi, Kisha Ortodokse Maqedonase, por edhe kjo nuk e dha tekstin e kumtesës në sajtin e vet.

Me aq sa u publikua në media nga ky takim, në takim u vendos për formimin e një këshilli i cili do të merret me integrimin e institucioneve arsimore fetare, fakultetet dhe shkollat e mesme fetare, në sistemin arsimor shtetëror të Maqedonisë si dhe për futjen e mësimbesimit në programet shkollore. Në takimin e mbajtur u konstatua pajtimi i përbashkët për rolin që ka feja dhe institucionet e saja në ndërtimin e vlerave pozitive dhe ato të moralit në shoqërinë tonë dhe se takimet e këtij lloji duhet të vazhdojnë. Poashtu liderët e bashkësive fetare kanë bërë apel për qytetarët që gjatë zgjedhjeve lokale të shfaqin sjellje dhe mirëkuptim të denjë ndëretnik dhe ndërkonfesional. Edhe në këtë takim krerët fetar, ndonëse kanë konstatuar se ka filluar procesi i denacionalizimit të pronave të bashkësive fetare, kanë kërkuar që i njëjti të përshpejtohet. Të nesërmen, kryeministri Vllado Buçkovski, në një takim të veçantë, i

ka pritë anëtarët e Sinodit të Kishës Ortodokse Maqedonase ku përveç tjerave kanë biseduar edhe për përfshirjen e bashkësive fetare në përgatitjet për miratimin e ligjit të ri për bashkësitë fetare në Republikën e Maqedonisë.

Me këtë të fundit si duket mbarojnë temat më të rëndësishme në relacionin shtet-bashkësi fetare dhe të cilat si duket definojnë marrëdhëniet e shtetit me bashkësitë fetare. Gjithsesi e para nga katër temat që herë pas herë bëhen objekt i trajtimit në media por shumë pak i studimeve të mirëfillta, janë: ligji i ri për bashkësitë fetare me të cilën do të mund të integrohen edhe me ligj ndryshimet e bëra kushtetutën e RM-së pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ku u shtuan edhe disa bashkësi fetare në kushtetutë. E dyta dhe më e përmendura nga vetë bashkësitë fetare është denacionalizimi i pronave të cilat janë në pronësi të bashkësive fetare në vendin tonë. Tema e tretë e që për mendimin tim është boshti i marrëdhënieve të shtetit me bashkësitë fetare është roli i tyre në shoqëri. Kjo gjithsesi është temë e gjerë për të cilën duhet bërë studime serioze dhe shteti duhet të ketë bazë të gjerë studimesh para se me ligj të ri ta kornizojë organizimin e jetës fetare. Kjo sepse çdo disbalans në relacionet e shtetit me fenë, në shoqëri multikonfesionale, si e jona, mund të ketë pasoja të mëdha në çalim të funksionalitetit të institucioneve. Pra, nëse njerëz fetarë bëjnë mallkime publike dhe anatema kundër ndarjes së re territoriale, organizojnë peticione për

të ndikuar në gjyqësi e tjera nga shembujt më të freskët në opinion, atëherë të tjerët, që nuk janë ata që bëjnë këtë, mund të ndihen në anën tjetër të balansit, kurse shteti përveç tjerave është përgjegjës edhe për kandarin dhe nuk duhet lejuar të i ndodhë kjo gjë.

Poashtu edhe për temën tjetër me rëndësi, futjen e mësim-besimit fetar në sistemin arsimor ekzistues shtetëror duhet bërë studime serioze dhe është mirë që këtë herë kjo nismë përmendet në formë të përgatitjes së një elaborati. E reja në këtë nismë, me të cilën edhe dallon nga nisma e mëparshme kur pa ligj dhe në shpejtësi u fut mësimbesimi në arsim, është edhe dimensionin tjetër ai i inkuadrimin të shkollave ekzistuese fetare në sistemin arsimor. Me këtë gjë në një plan afatgjatë do të fitohen kuadro të reja të cilat do të kenë përgatitje të nevojshme pedagogjike për mbajtjen e mësimbesimit nëpër shkollat fillore dhe të mesme, por edhe do të përshpejtohet nostrifikimi i diplomave të kuadrove ekzistuese, që kanë kryer studimet përkatëse në vend dhe jashtë tij. Kjo sepse deri tani ka pas raste kur nuk është kryer nostrifikimi i arsimit përkatës në fakultetet teologjike, ndonëse ato kanë qenë nga vende me të cilat shteti jonë ka nënshkruar marrëveshje ndërshtetërore për nostrifikim.

Mendojmë se iniciativa për mësim-besimin është një nismë e cila meriton të përshëndetet, mbetet që shteti, përkatësisht

Ministria e Arsimit dhe bashkësitë fetare ta kryejnë pjesën e vet të punës.

Argumentet pro futjes së mësim-besimit nëpër shkolla janë dhënë vazhdimisht në publikime të ndryshme, gjatë periudhës së kaluar kur mësim-besimi ishte në programet shkollore për një vit të tërë. Nga më të rëndësishmet vlen të ceket interesimi i madh që pati për këtë orë mësimore, ndonëse fakultative, nga ana e nxënësve anembanë shkollave fillore ku ajo u vendos. Poashtu edhe në aspektin e marrëdhënieve ndërkonfesionale mësim-besimi mund të ndikon pozitivisht pasi këto mësim në princip do ta zvogëlojnë shkallën e paditurisë të njerëzve ndaj njëri-tjetrit me çka zvogëlohen paragjykimet, por edhe fobitë eventuale që mund të paraqiten nëpër shoqëritë multi-etnike dhe multikonfesionale. Poashtu, mësim-besimi në këtë formë ndihmon që shteti të vendosë kriteret për përgatitjen e mësimdhënësve të kësaj lënde dhe me këtë një punë serioze si arsimimi i njerëzve me fetë e tyre të mos i mbetet as stihisë e as spontanitetit. Poashtu mësim-besimi mund të integrohet në "Programin nacional për zhvillim të arsimit" rishtazi të publikuar nga Ministria e Arsimit, pasi ky proces është në përputhshmëri me principet dhe vlerat e këtij programi dhe sidomos me mirëqenien sociale, kulturore, intelektuale dhe fizike të qytetarëve. Mirëqenie kjo e cila është e përmendur si vlerë gjenerale në të cilën mbështetet ky program nacional.

Ramadan RAMADANI,
4.3.2005

Koncepti i dashurisë

All-llahu, subhanehu ve teala, i ka ndihmuar robërit e Tij me dy gjëra, të cilat u mundësojnë të përqendrohen në rrugën e drejtë dhe të arrijnë lumturinë në këtë botë dhe ahiret, si dhe ato i ka bërë argument kundër tyre në ditën e gjykimit.

E para prej tyre është natyra e pastër e njeriut (el-fitrah, fitre, fitrati), në të cilën All-llahu i Madhërishëm e ka krijuar njeriun. Kurse e dyta është shpallja (el-vahj), me anë të së cilës All-llahu e përforcon natyrën e pastër njerëzore dhe e mbron atë nga ndikimi i shejtanit dhe epshit, të cilët mundohen ta njollosin atë.

Andaj, është shumë me rëndësi të dihet se nuk ka mundësi që këto dyja të bien në kundërshtim me njëra tjetrën, sepse All-llahu është Ai që e ka krijuar njeriun dhe Ai është që i ka dërguar atij Pejgamberë dhe Libra. Islami është në përputhshmëri të plotë me natyrën e pastër njerëzore në të gjitha aspektet e saj dhe çdo urdhër apo ndalesë e All-llahut është në dobi të njeriut dhe për t'i mbrojtur interesat e tij.

Prej ndjenjave që janë të ngulitura në shpirtin njerëzor është edhe ndjenja e dashurisë.

Origjina e të gjitha punëve të njeriut është dashuria. Njeriu nuk punon vetëm se për atë gjë që e do: ose për të arritur një dobi, ose për të zhdukur një dëm. Kjo është një gjë e ngulitur në shpirtin e njeriut. Mirëpo, dashuria e njeriut mund të jetë e drejtuar në anë të gabuar, mund të devijojë nga

rruga e shëndoshë dhe njeriu mund të bëjë padrejtësi, duke e vendosur dashurinë e tij në një vend të gabuar. Prandaj, All-llahu i Madhërishëm nga mëshira e Tij, i ka dërguar robërve të Tij Libër dhe Pejgamberë, që t'i mbrojnë ata të mos devijojnë nga rruga e drejtë dhe që t'i drejtojnë ndjenjat dhe veprat e tyre në kahjen e duhur.

Prandaj, nëse njeriu nuk e din konceptin islam mbi dashurinë, ai do të bëhet i padrejtë, duke e dashur më shumë atë që duhet të duhet më pak, duke e dashur atë që duhet të urrehet apo duke e urre atë që duhet dashur. Dhe nuk ka mundësi të shpëtojë nga kjo gjë, përveçse duke u udhëzuar me udhëzimet e All-llahut dhe porositë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

All-llahu, tebareke ve teala, thotë: "Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë." [Dharijat: 56].

All-llahu, subhanehu ve teala, është i Urtë, dhe çdo vepër e Tij ka urtësi dhe bëhet për një qëllim të urtë. All-llahu, subhanehu ve teala, na ka krijuar me një qëllim të vetëm, qëllim për të cilin i ka dërguar të dërguarit dhe i ka shpallur librat, e ai qëllim është: të adhurohet All-llahu, që është një dhe i pashoq, e mos ti drejtohet adhurimi askujt tjetër pos Tij.

Sa qëllim fisnik dhe çfarë nderi për njeriun!

E nëse njerëzit nuk e plotësojnë këtë mision, do të dënohen në dynja dhe ahiret. A ka më mjerim se sa njeriu të largohet nga

Zoti i Tij, zemra e Tij të jetë e zbrazur nga dashuria për Te dhe madhërimi i Tij?

E ceka këtë, që ta shohim vlerën e dashurisë, sepse adhurimi është grada më e lartë e dashurisë dhe nënshtrimit, dhe nuk ka mundësi të bëhet adhurimi pa dashuri.

Adhurimi i All-llahut është i ndërtuar mbi dashurinë, madje ajo është vërtetësia e adhurimit. Adhurimi përqendrohet në tri gjëra: dashuri, frikë dhe shpresë. Nëse ato bashkohen edhe adhurimi bën dobi, por nëse bie njëra prej tyre, atëherë adhurimi nuk është i saktë. Besimtarët e adhurojnë All-llahun me dashuri të madhe ndaj Tij, me frikë nga ndëshkimi i Tij dhe me shpresë për shpërblimin e Tij.

Nga kjo që thamë na bëhet e qartë se dashuria ndaj All-llahut duhet të jetë më e madhe se çdo dashuri tjetër, bile dashuritë tjera vijjnë si rezultat i dashurisë së All-llahut dhe bëhen për hir të All-llahut, tebareke ve teala.

Njeriu e do atë që i bënë mirë dhe që ka cilësi të mira, e All-llahu është Ai që njeriut ia ka dhënë të gjitha të mirat dhe Ai është që i ka të gjitha cilësitë e mira, andaj Ai është që e meriton dashurinë e plotë, e askush tjetër pos Tij.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Dhe ka prej njerëzve që marrin përveç All-llahut të adhuruar dhe i duan ata siç duan All-llahun..." [Bekare: 165].

Kush e do dikë sa All-llahun, apo më shumë, ai padyshim se është një mushrik (idhujtar), dhe kjo është shenjë e injorancës së madhe dhe kufrit të madh të atij njeriu.

Jeta e besimtarit është për All-llahun dhe me ndihmën e All-llahut, duke e pasur çdoherë ndërmend ajetin "Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë".

Kurse dashuria ndaj krijesave të All-llahut është për hir të All-llahut dhe aq sa janë të

nënshtruar ndaj All-llahut. Ata që janë robër të devotshëm të All-llahut i duam për hir të All-llahut, ata që janë besimtarë mëkatarë i duam aq sa është besimi i tyre dhe i urrejmë aq sa janë mëkatet e tyre, kurse ata që janë në kufër dhe kundërshtar të All-llahut dhe Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, i urrejmë plotësisht pa asnjë gram dashurie.

Prej krijesave nuk ka më të mirë, më të dashur te All-llahu, dhe me virtyte më të mira se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, andaj pas dashurisë ndaj All-llahut vjen dashuria ndaj Pejgamberit të Tij, sepse atë All-llahu e bëri shkak për të na larguar nga xhehenemi dhe punët që na shpijnë atje dhe për të na afruar drejt xhenetit dhe punëve që shpijnë atje. Nëpërmjet tij na rregullohen të gjitha çështjet e dynjasë dhe ahiretit.

Nuk ka krijesë që duhet të duhet më shumë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem. Dashuria ndaj tij është obligim dhe nuk ka mundësi njeriu të jetë besimtarë nëse nuk e do Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sellem. Dashuria ndaj tij duhet të jetë më e madhe se dashuria ndaj vetvetes, familjes, pasurisë dhe çdo gjëje tjetër.

Pas kësaj vjen dashuria ndaj Pejgamberëve tjerë, edhe atë sipas gradave të tyre, pastaj dashuria ndaj njerëzve tjerë sipas devotshmërisë së tyre, afërsisë së tyre me ne dhe bamirësisë së tyre ndaj nesh, si dashuria ndaj nënës, babait, gruas, fëmijëve, e kështu me radhë.

All-llahu është i drejtë dhe e do të drejtën, si dhe na urdhëron që në çdo gjë të jemi të drejtë. Kjo gjë vlen edhe për dashurinë tonë. Assesi nuk duhet të bëjmë padrejtësi, e sidomos kur është në pyetje dashuria ndaj All-llahut dhe të dërguarit të Tij.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Thuaj (o i dërguar): "Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se All-llahu, se i dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë, pritni derisa All-llahu të sjellë vendimin e Tij. E All-llahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur." [Teube: 24].

All-llahu e qorton ashpër atë që është i padrejtë në dashurinë e tij. Ky ajet tregon se dashuria e këtyre gjërave në origjinë nuk është diçka e keqe. Njeriu e do babain e tij, e do fëmijën e tij, e do vëllain e tij, e do fisin e tij, e do pasurinë e tij, e do tregtinë e tij, e do shtëpinë e tij. Origjina e dashurisë së këtyre gjërave është lejimi, sepse është prej dashurisë së natyrshme. Qortimi vjen kur këto gjëra janë më të dashura se All-llahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e All-llahut.

Njeriu nuk ka mundësi ta dojë All-llahun dhe të dërguarin e Tij, e gjithashtu ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Nuk ka vend në zemrën e besimtarit për dashuri ndaj All-llahut dhe ndaj kundërshtarëve të Tij. Nëse ekziston njëra, largohet tjetra.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe ditën e gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t'i shpjerë në xhennete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Aty janë përgjithmonë. All-llahu ua ka pëlqyer punën e tyre dhe ata janë të kënaqur me shpërblimin e Tij. Të tillët janë palë (grup, parti) e All-llahut, ta dini pra, se

ithtarët e All-llahut janë ata të shpëtuarit." [Muxhadele: 22].

Nuk e do besimtari kundërshtarin e All-llahut, po edhe në qoftë se e ka prind, fëmi apo diçka tjetër.

Konceptet e gabuara të dashurisë

Nëse njeriu largohet nga udhëzimi i All-llahut, atëherë do të gabojë dhe devijojë në çdo aspekt të jetës së tij, e poashtu do të devijojë edhe koncepti i tij mbi dashurinë. Një njeri i tillë do ta dojë më shumë atë që duhet ta dojë më pak, do ta urrejë atë që duhet ta dojë, po bile edhe do të arrijë në atë pikë që të adhurojë dikën tjetër përveç All-llahut, azze ve xhel, e ky është ai dështimi i qartë.

Njerëz të tillë shohim çdo ditë, shohim të tillë që e adhurojnë të dashurën e tyre, apo ndonjë këngëtar a këngëtare, artist a artiste, sportist a sportiste. Ka të tjerë që e adhurojnë pasurinë dhe çdo vepër e tyre është për këtë gjë. Krejt kjo është një shenjë e qartë e humbjes së madhe në të cilën gjenden këta njerëz, është shenjë e injorancës së tyre dhe kufrit që gjendet në zemrat e tyre.

Këta njerëz All-llahu i ka përshkruar kështu: "...Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët." [Araf: 179].

All-llahu e ka bërë njeriun krijesën më të ngritur, e ngritja e tij vjen nëse e adhuron All-llahun. Në të kundërtën, ai do të bëhet më i ulët së kafshët.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur. Pastaj e zbritëm atë në më të ultin e të ultëve. Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira; ata kanë shpërblim të pa-

ndërprerë." [Tin: 4-6].

Pra njeriu është krijesa më e lartë, përdërisa beson dhe bënë vepra të mira, e në të kundërtën, do të bëhet më i ulti i të ultëve.

A lejohet festimi i "ditës së dashurisë"?

Së pari: duhet ta kemi të qartë se festat janë pjesë e pandarë e fesë.

Së dyti: Feja islame është e vetmja fe e pranuar te All-llahu, kurse "fetë" tjera nuk janë tjetër veçse devijim nga rruga e peygamberëve dhe fryt i filozofisë njerëzore. Të gjithë peygamberët kanë thirë në islam, pra nënshtrim ndaj All-llahut.

Së treti: Feja islame është e përsosur dhe nuk ka nevojë që të shtohet diçka në te, e as të pakësohet.

Së katërti: Në islam festat janë të caktuara, e ato janë: dy bajramet dhe dita e xhuma. Nuk ka festa tjera me të cilat All-llahu është i kënaqur dhe kushdo që feston festa tjera vetëm se e ka pranuar idhujtarinë e tyre dhe ka shprehur pëlqim ndaj rrugës së tyre të devijuar. Kurse festa për të cilën bisedojmë tani quhet "Shën Valentini", gjë që tregon qartë se kjo nuk ka të bëjë me islamit e as me myslimanët.

Myslimanët nuk kanë nevojë për ditë të caktuar të dashurisë, sepse dashuria e tyre është e vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Kur-

se, këta që e kanë caktuar këtë ditë, nuk e dinë as definicionin e dashurisë e as që e kanë përjetuar dashurinë e vërtetë. Dashuria e tyre vetëm se ua shtonë dhimbjen dhe vuajtjen, sepse një zemër që se ka përjetuar dashurinë ndaj All-llahut është e destinuar për shkatërrim.

Së pesti: Ndalohet festimi i kësaj feste, ndalohet urimi atyre që e festojnë këtë festë dhe ndalohet veshja e simboleve të kësaj feste, si dhe blerja e dhuratave për këtë festë.

Si ka mundësi myslimani ta festojë festën e armiqve të tij, festën e atyre që ditë e natë punojnë për ta shkatërruar, festën e atyre që i përshkruajnë shokë All-llahut?

Mos vallë të krishterët i festojnë festat tona??

Çfarë populli është ai popull që me vetdëshirë asimilohet dhe e humb identitetin dhe fenë?

"E ti thuaj: "E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë. Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zjarr që muret e tij (të flakës) i rrethojnë ata, e nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran që përzhit fytyrat. E shëmtuar është ajo pije, e vend i keq është ai". [Kehf: 29].

Omer Islami,
11.2.2005

Djaloshi dhe mbreti

Imam Ahmedi transmeton nga Suhejbi se Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: Nga popujt që ishin para jush, ka qenë një mbret që ka pasur një magjistar, dhe kur ai magjistar është plakur, i ka thënë mbretit: “U plaka dhe koha ime gati mbaroi, pra të lutem ma sill një fëmijë të cilit do të mund t’ia mësoj magjitë”. Kështu, mbreti i solli atij një fëmijë dhe ky filloi t’ia mësojë magjitë.

Çdo herë që fëmija ka shkuar te magjistari, është ndalur te një dijetar dhe ka dëgjuar fjalimet e tij dhe është mahnitur.

Pra, çdoherë që ka shkuar te magjistari, ai ka kaluar pranë dijetarit, është ulur pranë tij dhe e ka dëgjuar; dhe kur ka shkuar tek magjistari ai e ka rrahur (për shkak të vonimit).

Kështu, djaloshi është ankuar tek dijetari. Dijetari i ka thënë atij: “Kur të kesh frikë nga magjistari, thuaj: ‘Më ndalën (vonuan) njerëzit e mi’ dhe kur të kesh frikë nga njerëzit e tu, thuaj: ‘magjistari më ndali!’”

Djaloshi vazhdoi ashtu (për një kohë). Pastaj në rrugë është paraqitur një krijesë e tmerrshme dhe njerëzit nuk mund të kalonin. Djaloshi ka thënë: “Sot do të di a magjistari është më i mirë apo dijetari”. Mori një gur dhe tha: “O Allah! Nëse punët e dijetarit pëlqehen nga Ti më shumë se ato të magjistarit, atëherë mbyt këtë krijesë që të mund të kalojnë njerëzit”. E gjuajti me gur, vrau krijesën dhe kështu njerëzit filluan ta kalojnë rrugën.

Djaloshi shkoi te dijetari dhe e informoi ate për ngjarjen. Dijetari i tha, “Biri im! Sot ti je më i mirë se unë, dhe ti e ke arritur atë

që e shoh! Do të gjykoresh (sprovoresh). Dhe në rast se gjykoresh, mos i informo (ata) për mua”.

Djaloshi kishte shëruar njerëzit e sëmurë nga verbëria e lindjes, leproza dhe nga sëmundje tjera. Një oborrtar i mbretit që ishte verbuar kishte dëgjuar për djaloshin. Ai kishte ardhur te djaloshi me një numër të dhuratave dhe i kishte thënë: “Nëse më shëron, të gjitha këto dhurata janë për ty”. Djaloshi është përgjigjur: “Unë nuk shëroj askënd; Allahu është Ai që i shëron njerëzit. Pra, nëse beson në Allahun dhe i lutesh Atij, Ai do të shërojë”.

Kështu, ai i besoi dhe iu lut Allahut dhe Allahu e shëroi atë.

Më vonë, oborrtari është kthyer tek mbreti dhe është ulur në vendin që ishte ulur më parë. Mbreti i ka thënë: “Kush ta ktheu shikimin?” Oborrtari është përgjigjur: “Zoti im”. Mbreti pastaj i ka thënë: “Unë”. Oborrtari është përgjigjur: “Jo, Zoti im dhe Zoti i jot – Allahu”. Mbreti e ka pyetur: “A ke ti Zot tjetër përveç meje?” Oborrtari i është përgjigjur: “Po, Zoti jot dhe Zoti im është Allahu”. Mbreti ka filluar ta torturojë atë pa ndalë, deri sa i ka treguar për djaloshin. Kështu, djaloshi është sjellur tek mbreti dhe mbreti i ka thënë: “O djalosh! A është rritur magjia jote deri në atë shkallë sa ti shëron verbëri nga lindja, leproza dhe sëmundje tjera?” Djaloshi është përgjigjur: “Unë nuk shëroj askënd. Vetëm Allahu, mund të shërojë”. Mbreti ka thënë: “Unë”. Djaloshi është përgjigjur: “Jo”. Pastaj mbreti e ka pyetur: “A ke ti Zot tjetër përveç

meje?” Djaloshi është përgjigjur: “Zoti im dhe Zoti jot është Allahu”. Kështu ai ka filluar ta torturojë deri sa i ka treguar për dijetarin.

Pastaj dijetari është sjellur tek mbreti dhe ai i ka thënë: “Heq dorë nga feja jote”. Dijetari ka refuzuar dhe kështu mbreti ka urdhëruar që të silltet një sharrë, që është vendosur në mes të kokës së tij, dhe ai ka rënë, i prerë në dy pjesë.

Pastaj i ka thënë njeriut që ishte i verbër: “Heq dorë nga feja jote”. Ai ka refuzuar dhe kështu mbreti ka urdhëruar që të silltet sharra që është vendosur në mes të kokës së tij, dhe ai ka rënë, i prerë në dy pjesë.

Pastaj e kanë sjellur djaloshin, të cilit i ka thënë: “Heq dorë nga feja jote”. Ai ka refuzuar dhe kështu mbreti e ka dërguar me disa njerëz në maje të një kodre. Mbreti u ka thënë njerëzve: “Ngjitu kodrës me të, deri sa të arrini në maje, dhe shihni nëse ai heq dorë nga feja e tij; nëse jo, hidhne teposhtë (nga maja)”. Ata u nisën me djaloshin dhe kur arritën në maje, ai tha: “O Allah! Më shpëto nga ata me çfarëdo mënyre që Ti dëshiron”. Kështu, kodra është dridhur dhe ata të gjithë kanë rënë teposhtë. Djaloshi është kthyer tek mbreti. Mbreti e ka pyetur: “Çka bënë shoqëruesit (njerëzit që i dërgova me ty)? Djaloshi është përgjigjur: “Allahu më shpëtoi nga ata”.

Mbreti ka urdhëruar disa njerëz të dërgojnë djaloshin me një anije deri në mes të detit dhe u ka thënë: “Nëse heq dorë nga feja e tij (mirë), por nëse refuzon, përmbysne”. Ata e dërguan atë deri në mes të detit dhe ai tha: “O Allah! Më shpëto nga ata me çfarëdo mënyre që ti dëshiron”. Kështu, të gjithë ata u përmbysën në det.

Pastaj djaloshi është kthyer tek mbreti dhe mbreti e ka pyetur: “Çka bënë shoqëruesit e tu?” Djaloshi është përgjigjur: “Allahu më shpëtoi nga ata”. Pastaj i ka thënë

mbretit: “Nuk do të kesh mundësi të më vrasësh deri sa të bësh atë që të urdhëroj. Nëse bën atë që të urdhëroj, do të mund të më vrasësh”. Mbreti e ka pyetur: “E, çka është ajo?” Djaloshi është përgjigjur: “Mblidhi njerëzit në një vend të lartë dhe më lidh për trungun e një druri; pastaj merr një shigjetë nga torba ime dhe thuaj: ‘Në emër të Allahut, Zotit të djaloshit’. Nëse e bën këtë, do të mund të më vrasësh”. Kështu, mbreti e bëri atë, vuri shigjetën në hark, dhe tha: “Në emër të Allahut, Zotit të djaloshit”. Shigjeta e qëlloi djaloshin dhe ai vendosi dorën mbi plagën e shigjetës dhe vdiq. Njerëzit deklaruan, “Ne besojmë në Zotin e djaloshit!”. Pastaj i thanë mbretit, “A nuk e pe që ndodhi ajo që ti kishe frikë. Për Allahun, të gjithë njerëzit kanë besuar (në Zotin e djaloshit).”

Kështu ai ka urdhëruar që të hapet një hendek në hyrjet e rrugëve. Kjo është bërë dhe ia kanë vënë zjarrin. Pastaj mbreti ka thënë: “Kushdo që heq dorë nga feja e tij, të lirohet, e kushdo që nuk heq dorë, hidhne në zjarr”. Ata ngulfateshin (digjeshin) në zjarr, deri sa erdhi një grua me foshnjën e saj, e cila ishte duke ushqyer në gji, dhe dukeshë se sikur ajo hezitonte të bie në zjarr, kur foshnja i thotë: “Ke durim nënë! Me të vërtetë ti je pasuese e të vërtetës!”

Edhe Muslimi e kanë regjistruar këtë hadith në fund të sahihut të tij.

Muhammed bin Ishak bin Jesar ka përfshirë këtë ngjarje në librin e tij të Sires (Siretu ibën Ishak) në një mënyrë tjetër, që ka një dallim nga ajo që sa po e përmendëm. Pastaj, pasi Ibën Ishaq ka sqaruar se populli i Nexhranit ka filluar fenë e djaloshit pas vrasjes së tij, që ka qenë feja e krishtere (jo ky i sotmi por sheriat i Isait, alejhis-selam v.r.), ai ka thënë: “Pastaj (mbreti) Dhu Nuvas u erdhi atyre me armatën e tij

dhe i ka ftuar në judaizëm. Ai u ka ofruar atyre zgjedhje; ose të pranojnë judaizmin ose të vriten, kështu ata zgjodhën vdekjen. Për këtë shkak ai ka hapur një hendek dhe ka djegur (disa nga ata) në zjarr (të hendekut), ndërsa disa të tjerë i ka vrarë me shpatë. Ai ka bërë shembuj ata (duke i vrarë) deri sa ka vrarë rreth 20 mijë prej tyre. Ja çfarë i shpalli Allahu, subhanehu ve teala, të Dërguarit të tij, rreth Dhu Nuvasit dhe armatës së tij:

“Mallkuar qofshin ata të zotët e hendeqeve. Të zjarrit me plot lëndë djegëse. Kur ata rrinin ulur rreth tij. Dhe dëshmonin atë që bënin me besimtarët. E nuk patën pse t'i urrejnë (të u hakmerren), përveç se ata e besuan All-llahun, Ngadhënjyesin, të lavdëruarin, Të cilit i takon sundimi i qiejve e i tokës; e All-llahu është dëshmitar i çdo sendi. (Buruxh: 4-9)

Kjo është ajo që Muhammed bin Ishak e ka thënë në librin e tij të Sires – se ai që i ka vrarë Njerëzit e Hendekut ka qenë Dhu

Nuvas dhe emri i tij ka qenë Zur'ah.

Dhu Nuvas, pra, ka vrarë 20 mijë vetë në një mëngjes në Hendek. Vetëm një njeri nga ata ka ikur. Ai njiheshe si Dava Dhu Tha'laban. Ai ka ikur me kalë, edhe pse ata ata iu ngjitën prapa, nuk arritën ta kapin. Ai ka shkuar te Cezari, perandori i atëhershëm i Shomit.

Pastaj, Cezari i ka shkruar En-Nexhashiut, mbretit të Abisinisë. Kështu, ai ka dërguar një armatë të krishterëve abisinianë, të cilët u udhëhoqën nga Erjat dhe Ebreha. Ata e çliruan Jemenin nga duart e hebrenjve. Dhu Nuvas u përpoq të ikë, por ka rënë në det dhe është mbytur. Pas kësaj, Jemeni mbeti nën pushtetin e krishterë për 70 vjet. Pastaj pushteti është marrë nga krishterët nga Sejf bin Dhi Jazin El-Himjari, kur Kisra, mbreti i Persisë dërgoi armatë në Jemen. Ai (mbreti) i dërgoi me Sejf el-Himjarin njerëzit që ishin nëpër burgje, që në numër ishin rreth 700. Kështu, Sejf el-Himjari pushtoi Jemenin me ata, dhe ua ktheu mbretërinë popullit të Himjarit (jemenasve).

Imâm Ibën Kethîr

Marrë nga libri: El bidaje ven nihaje, vëllimi i dytë, tregimi i ashabul uhud
përktheu: xh.a.

redaktoi: Alblislam.Com

18.2.2005

Kërkimi i të vërtetës, fuqisë dhe qëllimit

Që nga fëmijëria e hershme, nga koha kur kam filluar të mbaj mend, unë kam qenë në kërkim të domethënies së jetës. Pse jam këtu? Cili është qëllimi im? Parashtrimi i vazhdueshëm i këtyre pyetjeve më bëri më ndryshe nga fëmijët tjerë. Ai ishte ndryshim i brendshëm dhe kureshtar; parashtroja pyetje tërë kohën - e më e parapëlqyera ishte "Pse?". Fjalët e gjyshit gjithnjë e më shpesh më tingëllonin në vesh. "Zoti nuk i krijon njerëzit vetëm për të mbushur vendin në tokë". Vetëm deri paradokhohe kuptova ndikimin që kjo thënie e kishte pasur tek unë. Më duheshe të kuptoj: nëse askush nuk është këtu për të "mbushur vendin", atëherë pse jam unë këtu? Kjo etje për kuptuar qëllim nxiti tek unë dëshirën për të gjetur vendin dhe qëllimin tim në gjithësi.

Më kujtohet se si vështroja botën rreth meje në mënyrë dëshpëruese duke u përpjekur të kuptoj se pse bota është ashtu siç është; pse njerëzit besojnë në atë që besojnë, dhe çka i shtyn ata t'i bëjnë gjërat që i bëjnë. Kërkimin (hulumtimin) tim e fillova nga brendia, dhe ngadalë kërkimi filloi të gërmojë përgjigjet e atyre rreth meje. Ndoshta përgjigjen e din dikush që e njoh.

Përderisa nga njëra anë familja që kujdeseshe për mua ishte rreth meje, nga ana tjetër ishin të tjerët që më trembnin dhe lëndonin me fjalët dhe veprimet e tyre. Ndonjëherë njerëzit nuk e shohin se fjalët janë të fuqishme sa armët, sidomos në jetën e fëmijës. Unë kisha shumë sende që ma shponin zemrën; disa janë shëruar ndërsa disa thjesht janë zbehur, janë

bllokuar nga një mendje që kërkonte mbrojtje nga të këqijat e realitetit. Në shumë mënyra unë u bëra viktimë, por në shumë mënyra tjera mbijetova. Një gjë çdoherë ishte e sigurt - asnjëherë nuk dëshiroja që e njëjta t'i ndodh dikujt tjetër. Edhe pse asnjëherë nuk u mlllefosa si duhet, unë u frustrova. Rrethanat e mia më motivonin edhe më shumë të kuptoj se pse njerëzit i bëjnë gjërat që i bëjnë. Përderisa vështroja fjalët dhe veprat e njerëzve, habia e madhe që kisha për ta më shtyri të filloj një udhëtim shpirtëror në një moshë shumë të re. Në atë kohë isha 10 vjeçar dhe kërkimi im për të kuptuar qëllimin vazhdoi.

A mund që qëllimi të vijë nga një burim i vetëm? Unë besoj se po, mirëpo kur ajo vjen nga njerëzit tjerë, një shkak, një ndjenjë nuk mund të zgjasë çdoherë. Për shembull një person që investon në një çështje për shkak të të dashurit/dashurës, ose për shkak të dëshirës, ose për shkak të nevojës për t'u ndjerë mirë, ose për diçka që e shohin, atëherë qëllimi mund të jetë relativ, dhe ai mund të heq dorë nga rrethanat dhe faktorët e ambientit, duke i ndryshuar ndjenjat, ose madje edhe nga sfidat që i ofrojnë të tjerët. Megjithatë, kam mësuar se qëllimi i rrjedhur nga një burim hyjnor, brenda parametrave të definuara qartë dhe me një kuptim të pastër të përgjegjësisë personale ndaj Krijuesit, tejkalon jetët e vetë njerëzve.

I lindur në një familje hindu-kristere, isha nënshtruar të shoh më shumë mënyra të botës se sa që është i nënshtruar një

fëmijë i zakonshëm. Shkollimin fillestar e ndjeka në një shkollë hindu, ndërsa shkollimin e mesëm në një shkollë katolike. Gjatë lundrimit nëpër ujërat e turbullta të religjionit dhe mënyrave të ndryshme të vështrimit të botës, ndjeja se më në fund e kisha gjetur çelësin, përgjigjen; gjënë që më tregonte se pse unë jam këtu, duke më furnizuar me energji të nevojshme dhe një kornizë për ta plotësuar qëllimin tim. Korniza sqaronte se aspektet e jetës sime të përditshme ishin lutjet dhe e gjithë ajo ishte e bazuar në një marrëdhënie të pavarur me Zotin. Korniza ishte ajo që ftonte për përgjegjësi personale, duke ditur se Zoti dëshiron që ne të jemi udhëheqës, dhe se çfarëdo që nuk bëhet në emër të Zotit është e kotë. Veprat që bëhen për famë, mirënjohje ose madje edhe për t'u ndjerë mirë asnjëherë nuk do të zgjasnin. Ato mund të na sjellin dobi në këtë botë, por nuk do të ketë asnjë dobi në botën tjetër. Në vend të kësaj, siç e kuptoja unë, Zoti na fton ta ngremë veten, të dimë se veprat tona do të gjykohen, por jo nga rezultatet e qëllimeve tona, dhe se edhe kur njerëzit nuk shohin, Zoti çdoherë shef. Në moshën 11 vjeçare, u bëra musliman.

Në atë kohë, kjo nuk ishte një zgjidhje e lehtë nga frika e reagimit të familjes sime. Ata do të praninin shumë nga unë, por jo Islamin. Unë isha një shembull "i mençur" dhe i ndritshëm. Kisha potencial, të cilin do ta humbja para syve të tyre po të bëhesha musliman. Siç druajnë shumë prindër sot, nëna ime druante se do të bëhem ndonjë militant që do të vret njerëz në emër të Allahut. Duheshe të kalojnë shtatë vjet përpjekje të heshtura, për t'ua bërë me dije se unë e kisha marrë këtë vendim. Për ata kjo ishte një kafshatë e vështirë për ta qëlltitur, por nuk patën tjetër rrugëdalje.

Tani shoh se sot është shumë më vështi-

rë të jesh musliman; sot të jesh musliman është sikur të mbash një etiketë që shkruan "armik". Por çdoherë kur nuk mendoj për marrjen e këtij vendimi, bëhem më i fuqishëm dhe bindem edhe më shumë se vërtetë kam kuptuar pse jam krijuar dhe cili është qëllimi im. Kjo ka përforcuar këmbëngulësinë të "jetoj dhe të vdes" për Zotin - Allahun.

Fotografia e përgjithshme

Atë që e shihja si qëllim në atë kohë, kam filluar ta kuptoj tani. Qëllimi im në këtë jetë është ta adhuroj Krijuesin e Qiejve dhe Tokës. Adhurimi në këtë kuptim nuk ka të bëjë vetëm me rituale. Adhurimi ka të bëjë me një dëshirë të përgjithshme për të jetuar në një mënyrë që kënaq Atë që na ka krijuar, për të kuptuar se nëse ne shpresojmë mëshirën e Tij, atëherë ne duhet të tregojmë mëshirë. Për të kuptuar se përderisa i duam të tjerët, edhe të tjerët do na duan, përderisa lutemi për të tjerët, vetë engjëjt do të luten për ne. Në një kuptim shumë të vërtetë besoj se Zoti më ka krijuar në këtë botë për të plotësuar një mision të shenjtë: të përkrrah të vërtetën dhe drejtësinë për njerëzit, pavarësisht nga dallimet sipërfaqësore...

Gjeta një marrëdhënie të posaçme dhe të ngushtë me Zotin, që shtron rrugën e përgjithshme për ta jetuar jetën time. Kjo rrugë më tregon se unë do të përpiqem të jem ndër krijesat më të mira, krijesë që kujdeset për gjithë krijesat, duke e urdhëruar të lejuarën dhe duke e ndaluar të ndaluarën. Kjo do të thotë se unë çdoherë duhet të flas të vërtetën, pavarësisht nga pasojat. Kjo posashtu do të thotë se për të qenë më i mirë që kam mundësi të jem, duhet të mbroj jetën dhe të siguroj se njerëzit në asnjë mënyrë nuk do të shtypen. Kjo do të thotë se unë duhet të jem ambasador i mëshirës, pasi kjo është vullë e Islamit. E di se të gj-

tha veprat e mia i kam bërë vetëm për të kënaqur Allahun. Ia kam dedikuar jetën Atij dhe nëse vdes duke ecur kësaj rruge, atëherë unë vdes për hir të Atij (e jo siç përshkruhet sot nëpër media në mënyrë sensacionale)

Bindja se ky ishte misioni im nuk mjaftonte. Studiova shembullin e të Dërguarit Islam, Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Lexova për një njeri që udhëhoqi një grup të njerëzve, të cilët e ndryshuan njerëzimin përgjithmonë. Ai ishte analfabet, dhe edhe pse ishte një udhëheqës i fuqishëm, ai asnjëherë nuk ka fjetur nëse ka poseduar të holla (pasuri): do të shkonte dhe do t'ua shpërndante të varfërve. Pash një njeri që, edhe pse ishte udhëheqës, ka fjetur përtokë, duke mos lejuar që shqetësimet e kësaj bote të garojnë për vëmendjen e tij. Ai i mbeti besnik qëllimit të tij. Pash një njeri që kur ka pushtuar një qytet në kohë lufte, nuk ka derdhur pikë gjaku, dhe më pas ua ka falur armiqve të cilët e kishin maltretuar atë vite me radhë.

Më vonë vazhdova të mësoj për të dërguarit tjerë Islam - Isain a.s., Musain a.s., Ibrahimin a.s. - dhe për një numër të madh të njerëzve që flisnin me respekt të madh për Kur'anin. Vështroja Asiyën (gruan e Faraonit, Firaunit), Merjemen (nënë e Isait a.s.) dhe pastaj vështroja udhëheqësit bashkëkohorë dhe shumë të tjerë, nga të cilët nxora inspirim. Duke i vështuar jetët e tyre, mësova se të gjithë ata ishin individë të posaçëm që kishin kuptuar diçka për jetën. Ajo nuk ishte thjeshtë vetëm për shërbim, por ajo ishte për ndryshim. Ajo kishte të bëjë me transformimin e botës në të cilën jetonin ata. Çdo person përkrahte fuqishëm të vërtetën. Ata mbanin qetësinë në ujërat e shqetësuar dhe punonin për të arritur një fitore morale në botë. Pas kësaj kalova shumë vjet duke u munduar të kup-

toj se çka duhet të bëj me jetën time.

Mësimi i qëllimit tim në jetë

U mundova tepër të plotësoj këtë qëllim duke u involvuar në komunitet; u bëra mjaft aktiv në shërbimet shoqërore dhe aktivitetet rinore, duke u kujdesur për shumë njerëz që nuk i kishin të drejtat themelore qytetare. Isha i sigurt se dëshiroja t'ju ndihmoj njerëzve dhe se nuk do të qëndroja i qetë dhe të lejoja dikush ta lëndojë dikë. Më kujtoheshin plagët e betejave që i kisha, dhe nuk dëshiroja që dikush tjetër ta përjetojë të njëjtën.

Pastaj një ditë, pas mendimeve të shumta dhe disa nxitje të buta nga miqtë të cilët shihnin tek unë më shumë se sa shihja unë te vetja, kuptova një nga mënyrat më të mira për ta arritur qëllimin tim.

Si mund të përkrah të vërtetën, të ndaloj të ndaluarën, të jem i mëshirshëm, të përkrah drejtësinë, të nxis veten edhe më shumë për të ndryshuar dhe transformuar botën? Si do të mund të lë ndikimin tim në botë, si yjet që shkëlqejnë? Mu duk sikur u ngrit një perde. Në zemrën time lindi një shpresë - duheshe të bëhem mësues. Kjo ishte një zgjerim natyror i asaj që e përkrahja si qëllim, ndikimi i së cilës do të ishte i pamatshëm. Në Islam ajo quhet sadaka xharije - një lloj i sadakasë që vazhdon të jetë e dobishme për personin edhe pas vdekjes.

Rinia

Në këtë mënyrë do të mund ta ndryshoja botën. Secilin fëmijë që mësoja, do të merrte një zjarr prej meje dhe do ta përdorte për t'i ndezur llambat tjera. Derisa kuptova këtë, e dija se nuk kam dashur të mësoj çfarëdo fëmije. Doja t'i qasem sferave të ndryshme dhe t'i gjej fëmijët që nuk kishin përparësitë e njëjta si fëmijët tjerë, fëmijët

që shiheshin ndryshe, fëmijët që ishin etiketuar si “në rrezik”. Doja t’ju tregoj se pavarësisht nga pengesat që jeta ua ka shtruar atyre, dikush ishte në gjendje t’ju ndihmojë. Unë do të isha ai që do t’i anashkalonte fjalët dhe reputacionet e tyre dhe do t’i shihja në sy, do t’i shihja zemrat e tyre, dhe do t’i njihja në brendi - atë që gjendet prapa gjitha shtresave. Unë isha ai që do t’i nxiste ata të bëhen ata që mund të bëhen, dhe ai që ishte në gjendje të jep mund plotësues t’ju ndihmojë atyre ta shohin atë tek vetja. Dëshiroja t’ua jap veglat që do t’ju ndihmojnë atyre të bëhen të suksesshëm, duke i sfiduar ata dhe duke i inkurajuar të bëhen mendimtarë kritikë dhe të mësojnë se si ta përkrahin veten.

Duke vështruar “trashëgimin” tim Islam, mësova se kurdo që muslimanët fokusohen në atë që Zoti e dëshiron, ajo ndikon pozitivisht tek të gjithë njerëzit. Kjo ndodh pavarësisht se ku ose kush është, në çka beson ose prej nga vjen. Ata të gjithë janë të mbrojtur dhe të lirë. Asnjëherë nuk kam dashur që ndonjë nxënës i imi të ndjehet i armiqësuar; ajo ishte një gjë që e kisha përjetuar dhe në asnjë mënyrë nuk doja që ndonjë fëmijë tjetër ta kalojë të njëjtën. Kjo ishte e rrënjësor thellë në fenë time, kështu fillova të zhvilloj një filozofi të qartë dhe të hollësishme për atë se çka do të thotë të jesh mësues. Çdoherë i kthehem asaj; vazhdoj ta vizitoj shpesh, me shpresë se do të qëndroj i palëkundur ndaj qëllimit dhe profesionit tim.

Dhe kështu sot jam mësues, i përcaktuar për ta transformuar botën pjesërisht nëpër-

mjet nxënësve që i mësoj dhe që më mësojnë mua. Kemi marrëdhënie reciproke; unë u ndihmoj atyre të njohin veten dhe mua. Së bashku mundohemi të kuptojmë veten, shoqërinë dhe botën në të cilën jetojmë dhe të plotësojmë atë qëllim nëpërmjet veprave tona. Përpjekjet e tyre janë njëjtë sfiduese si përpjekjet e mia.

Për shkak se jam musliman, çdoherë që dëgjoj fjalë të urrejtshme nëpër media ose nga ndonjë kalimtar, më rritet dashuria që kam për t’ua dhënë atyre. Zakonisht frika formohet nga e panjohura, dhe kur më njohin nxënësit e mi, ata e dinë se unë nuk jam “lugati” siç më quajnë mediat. Ata e dinë se në ditën kur aeroplanët goditën kullat bineqe, zemra ime ka vuajtur dhe unë kam qarë, njëjtë siç kam qarë në ditën kur kanë filluar bombat të bien në Afganistan dhe Irak; se kur shoh një person të pastrehë, mua më shkon mendja në komforin që e kam në shtëpi, dhe mundohem të bëj diçka që, së paku për një moment, të ndryshojë mënyrën që njeriu duhet të jetojë; se terrorizmi nuk ka ngjyrë ose besim, dhe kështu të gjithë ne nuk duhet të ngjyrosmi me të njëjtën brushë. Nuk kam nevojë më të jem shfajësues. Nuk kam nevojë të fshihem, për shkak se tani nxënësit e mi shohin se kush jam unë, si individ, si musliman, si mësues, si shok, si baba, dhe si një person që kujdeset. Sa më shumë që mendoj për Islamin, aq më shumë e kuptoj qëllimin tim, dhe aq më shumë mendoj për mësimdhënien si mënyrë për të plotësuar atë qëllim. Më ndihmën e Zotit, mund të bëj, dhe do të bëj ndryshime.

Jeewan Chanicka

(Autori është nga Toronto, Kanada dhe nga viti 1993 është i angazhuar në shërbimet sociale, në arsimim të të rinjve.) përktheu: xh.a.

25.2.2005

Kape të sotmen, e nesërmja nuk është e jotja

Pasi mora vesh për vdekjen e një miku musliman, fillova të mendoj se sa e shkurtë dhe e shpejtë është jeta, dhe se unë jam larg tij vetëm sa të mbyll dhe të hap sytë.

Vdekja është një realitet nga i cili askush nuk mund të ikë. Ajo afrohet çdo ditë e më afër, çdo orë, çdo minutë. E pyeta veten, nëse do të vdisja sot, a do të isha ajo që i kam bërë të gjitha veprat për të siguruar rizanë (Kënaqësinë) e Allahut, dhe për t'iu shmangur Zemërimin të Tij? Për fat të keq, për mua përgjigja ishte JOOO.

Sërish e pyes veten, çfarë vepre të mirë kam bërë që do të jetë e dobishme për shpirtin tim? Dhe sërish, përgjigja ishte negative - shumë pak. Koha, siç e shohim, po kalon shumë shpejt. Më duket sikur dje filluam "Vitin e ri", ndërsa në realitet kemi kaluar një pjesë të mirë të tij. Një muaj duket sa një javë, një javë duket sa një orë, dhe një orë duket sa disa minuta. Për këtë shkak vendosa të bëj çmos, me ndihmën e Allahut, të shfrytëzoj çdo rast për të bërë vepra të mira, e mos t'i lë për më vonë gjërat që mund t'i bëj tani.

Vdekja po vjen, a je gati?

Allahu thotë: "Secili njeri do të shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen ditën e kijametit, e kush shmanget zjarrin e futet në xhenet, ai ka arritur shpëtim, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos një përjetim mashtrues. (Ali Imran: 185)

Është shumë lehtë që ne të ngatërrohemi në zhvillimet e përditshme të jetës, tentojmë të harrojmë se nuk jemi përgjithmonë në këtë botë, dhe të largohemi nga qëllimi i

vërtetë. Sikur harrojmë se në këtë botë kemi ardhur për ta adhuruar Allahun dhe për të përfituar nga rastet e ndryshme. Ai na lejon që ne të grumbullojmë pasurinë tonë në Xhennet. Për shkak se Ai, subhanehu ve te'ala, poashtu thotë:

"O ju që besuat, kini parasysh frikën ndaj All-llahut dhe le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër, dhe kini frikë All-llahun, e s'ka dyshim se All-llahu është që e di në detaje atë që punoni! E mos u bëni si ata që e harruan All-llahun, e All-llahu bëri që ata ta harrojnë vetveten! Të tillët janë ata të prishurit. Nuk janë të barabartë ata të Xhennetit dhe ata të Xhehennemit. Banuesit e Xhennetit janë ata fatbardhë që ia kanë arritur qëllimit". (Hashr: 18-20)

Ai poashtu na tregon se ne nuk e dimë momentin ose vendin e vdekjes. Mirëpo, Ai, nëpërmjet Mëshirës së pafund ndaj nesh, na ka dhënë mënyra për t'u përgatitur për të pashmangshmen tani! Sepse kur ta kalojmë këtë botë e të dalim në tjetrën, nuk ka kthim prapa për t'i bërë punët që është dashur t'i bëjmë. Allahu thotë:

"E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!" Kurrsesi, (Kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) deri në ditën kur ringjallen". (Mu'minun: 99-100)

Allahu na ka dhënë mënyra për ta mbrojtur veten nga dënimi i varrit. Një nga këto mënyra është lufta në rrugë të Allahut. Transmetohet se një njeri ka pyetur Muha-

mmedin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem: “O i Dërguari i Allahut pse të gjithë besimtarët sprovohen në varr përveç shehidëve (dëshmorëve)? Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i është përgjigjur: “Shkëlqimi i shpatave mbi kokën e tij ka qenë provë e mjaftueshme për të”. (en-Nesai)

Kjo mund të jetë e vështirë për shumicën prej nesh në këtë kohë, mirëpo Allahu na ka ofruar shumë mënyra tjera për ta fituar lehtësimin në Ahiret. Këtu përfshihet leximi i sures el-Mulk, për shkak se Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Sureja Tebarek është mbrojtëse nga torturat e varrit” (Hakimi). Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, poashtu ka thënë: “Kur vdes një njeri, të gjitha veprat i ndalen përveç sadakasë rrjedhëse, diturisë nga e cila përfitojnë të tjerët dhe fëmijës së mirë i cili lutet për të” (Muslimi)

Një mënyrë tjetër për të përfituar shpërblim të vazhdueshëm është ngjallja e ndonjë sunetit të Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ai, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Ai që fillon një mënyrë të mirë në Islam shpërblehet për të, duke përfshirë edhe shpërblimet për ata që e pasojnë atë, pa u zvogëluar asnjë nga shpërblimet e tyre” (Muslimi)

Për ata që njohin muslimanë që kanë filluar udhëtimin e tyre, ose që janë gati ta fillojnë atë, për në botën tjetër, ekzistojnë gjëra që ndihmojnë në kalim sa më të lehtë, inshaAllah. Këtu përfshihet falja e namazit të xhenazes, plotësimi i premtimeve të të vdekurit, larjes së borxheve të të vdekurit dhe lutjes për muslimanët.

Jeta po ik. Vdekja po afrohet. Le të bëhemi gati...

Sumejja bint Xhoan
përktheu: xh.a.
4.3.2005

Kalendari i hixhretit

Fillimi i numërimit të viteve ka filluar me një rast në islam, e ai është hixhreti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, hap me të cilin filloi themelimi i ummetit islam në një vend islam dhe të pavarur, ku sundonin muslimanët. Ky vend ishte Medineja, Taibeja, vendi ku u shpërngul Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Kalendari vjetor nuk është përdorur në fillim të Islamit deri në kohën e Omerit, radijall-llahu anhu.

Në vitin e tretë ose të katërt të sundimit të tij, i shkroi letër Ebu Musa Eshariu, radijall-llahu anhu, duke i thënë: na vijnë letra prej teje, mirëpo nuk kanë datë. Atëherë Omeri, radijall-llahu anhu, i grumbulloi sahabet, radijall-llahu anhum, dhe i konsultoi. Disa prej tyre thanë: filloni kalendarin sikur e bëjnë persianët. Ata si bazë të kalendarit e kanë vdekjen e mbretërve të tyre. Këtë e urrejtën sahabet. Disa thënë: fillojeni kalendarin sikurse veprojnë romakët. Edhe këtë e urrejtën. Disa tjerë thanë: filloni kalendarin me lindjen e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Kurse të katërtit thanë: fillojeni kalendarin me vitin e fillimit të shpalljes. Të pestët thanë: fillojeni kalendarin me shpërnguljen e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Omeri, radijall-llahu anhu, tha: Hixhreti e ndau të vërtetën nga e kota, andaj sipas hixhretit filloni kalendarin. Sahabet u pajtuan me këtë qëndrim të Omerit. Pastaj u konsultuan se nga cili muaj ta fillojnë vitin. Disa thanë: ta fillojmë nga

Ramazani, sepse në këtë muaj ka filluar zbritja e Kur'anit. Të tjerët thanë: të fillojmë nga muaji Rebiul-Evel, sepse është muaji në të cilin Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, erdhi si muhaxhir në Medinë. Kurse Omeri, Othmani dhe Aliu, radijall-llahu anhum, propozuan që viti të fillon nga muaji Muharem, sepse vjen pas muajit Dhil-Hixhe, që është muaji i haxhit, vepër më të cilën plotësohen shtyllat e fesë. Në këtë muaj ka ndodhur edhe besatimi mes ensarëve dhe Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe është marrë vendimi për hixhret. Andaj filloi regjistrimi i vitit islamik dhe sipas hixhretit nga muaji Muharem.

Musliman të nderuar! Kështu ka filluar historia islame. Është fatkeqësi që shumica e muslimanëve ta lënë kalendarin islam dhe hixhretor e ta zëvendësojnë me kalendari krishterë dhe gregorian.

Shumica e muslimanëve, sot, fatkeqësisht, i mbështeten kalendarit gregorian e jo atij sipas hixhretit. Kurse kalendari gregorian aspak nuk ka lidhje me fenë e muslimanëve.

Nëse dikush ka patë një gjysmë arsyetimi dje për shkak të kolonializmit, i cili i shtyri ta harrojnë kalendarin islamik, sot nuk e kanë këtë arsyetim.

Ne nuk dyshojmë se disa vende të muslimanëve i okupuan të krishterët dhe dëshiruan tua ndërrojnë besimin, historinë, metodën dhe shoqërinë e tyre. Ata edhe arritën sukses në disa gjëra që dëshiruan, mirëpo ne u themi, sot, nuk keni arsye, pasi

që jeni pavarësuar dhe e largoi All-llahu prej jush ankthit e kolonizatorëve, padrejtësinë dhe torturat e tyre.

Dëgjuat se si sahabet kanë urre kalendarin e persianëve dhe romakëve.

Musliman të nderuar! Jemi në fillimin e vitit të ri islamik dhe sipas hixhretit. Muajt e këtij viti janë lunare, të cilat janë te regjistruara në Libër të All-llahut:

"Te All-llahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës), ashtu si është në librin e All-llahut prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre katër janë të shenjtë. ...". (Et-Teube: 36).

Muajt që All-llahu i ka bërë kalendar për mbarë botën: "Të pyesin ty për hënën e re (dhe fazat e saj) Thuaj: "Ato janë përcaktime të kohës për njerëz ...". (El-Bekare: 189).

Kalendar për mbarë njerëzit, pa dallime mes arabëve dhe joarabëve, sepse janë shenja të prekshme dhe të dukshme për secilin njeri, sipas të cilit kalendar ndodh hyrja dhe dalja e muajit. Atëherë kur e sheh hënën e re hyn muaji i ri dhe përfundon muaji i vjetër. Këto muaj lunar janë muaj te All-llahu, e jo sikur muajt gregorian. Ato nuk janë të qarta dhe nuk mbështeten në gjëra fetare, logjike e as në gjëra matematikore, por janë muaj terminologjik dhe të ndryshëm. Disa prej tyre arrijnë deri në tredhjet e një ditë e disa më pak se njëzet e nëntë ditë. Kurse ky dallim nuk ka ndonjë shkak të vërtetë logjik. Andaj disa njerëz të mençur krishterë kanë propozuar që t'i ndryshojnë këto muaj, mirëpo e refuzuan këtë priftërinjtë dhe murgjërët e krishterë.

Që nga dita që është ndryshuar kalendarit islamik në disa vende muslimane, kalendar i cili është për mbarë besimtarët, ata kanë marrë kalendarin gregorian. Është fatkeqësi e madhe që priftërinjtë dhe murgjërët e të

krishterëve dhe çifutëve të jenë më xheloz se sa dijetarët musliman. Kjo është një sprovë e madhe që i ka goditur muslimanët, sepse kanë kompleks të inferioritetit. E po mos ta kishin këtë kompleks ata do të ndiheshin krenar dhe të ndershëm dhe do të formulonin personalitet të vetëm dhe të rrallë, nuk do të frikoheshin ta ndryshojnë atë që e kanë mbjellë kolonizatorët.

E kanë pyetur Imam Ahmedin, rahimehull-llah, duke i thënë: persianët kanë ditë dhe muaj që i kanë emërtuar me emra që nuk njihen. Ai këtë shumë e urrejti.

Transmetohet nga Muxhahidi, i cili është Imam i mufesirëve dhe është prej tabiinëve se e ka urrejtur të thuhet Azar, sepse është emër i muajve gregorian.

Musliman të nderuar! Jemi duke hyrë në një vit të ri islamik dhe lunar, kurse nuk është prej Sunnetit të shpikim festa për shkak të ardhjes së këtij viti të ri, duke i bërë të zakonshme urimet për ardhjen e këtij viti. Disa njerëz ua urojnë ardhjen e këtij viti të ri, mirëpo kjo nuk është prej sunnetit, madje nuk është prej lakmisë, sepse nuk ka lakmi në kalimin e shumë viteve, por lakmia është në vitet që i ka kaluar besimtari në adhurime ndaj All-llahut. Shumë vitet janë të mira për atë që i ka kaluar në adhurime kurse të këqija për atë që i ka kaluar në mëkate ndaj All-llahut. Njerëzit më të këqij janë ata që jetojnë gjatë dhe punojnë keq.

Vëllezër musliman! Ne duhet t'i presim ditët, muajt dhe vitet me respekt ndaj All-llahut, duke llogaritur veten dhe duke përmirësuar veprat tona të prishura, duke i mbikëqyrur ata që All-llahu na i ka lënë në përgjegjësi, qofshin gratë, fëmijët, djemtë dhe vajzat, e të afërmit.

Keni frikë All-llahun, o ju robër të All-llahut, zbatoni detyrat tuaja dhe për të cilat

do të jepni llogari në ditën e Kijametit, ruani veten dhe familjen tuaj nga zjari i xhehemit, ku lëndë djegëse do të jenë njerëzit dhe gurët. Kryeni këto detyra në formën më të plotë, ose së paku pjesën obligative që e keni.

O ju njerëz, dini se gjymtyrët do t'i keni hasmin tuaj në ditën e Kijametit. Atë ditë do të vuloset goja dhe do të flasin duart dhe këmbët për atë që kanë fituar.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"E derisa afrohen atij, kundër tyre dëshmojnë: të dëgjuarit e tyre, të parit e tyre dhe lëkurat e tyre për çdo gjë që ata kanë punuar. Ata lëkurave të tyre u thonë: "Përse dëshmuat kundër nesh?" Ato thonë: "All-llahu që çdo sendi ia ka dhënë të folurit na dha edhe neve, e Ai është që ju krijoi juve herën e parë dhe vetëm te Ai ktheheni". Ju nuk fshiheshit (kur bënit mëkate) se do të dëshmojnë kundër jush të dëgjuarit tuaj, të pamurit tuaj dhe lëkurat tuaja, bile ju mendojnë se All-llahu nuk di për shumë gjëra që ju i bënit. Mendimi juaj i gabuar, të cilin e patët ndaj Zotit tuaj, është ai që ju shkatërrroi dhe tani jeni më të dëshpëruarit". (Fussilet: 20 – 23).

Robër të All-llahut! Secili vit që përfundon i premtion njeriu vetes vendosmëri të vërtetë dhe seriozitet, mirëpo kalojnë ditët, palohen orët, kurse gjendja e tij nuk ka ndryshuar. Në fund pendohet dhe dështon, andaj shfrytëzoni kohën, o ju robër të All-llahut, në adhurime dhe në secilin vit bëhuni më të mirë se në vitin e kaluar. Sepse secili vit që vjen ju afron edhe më shumë drejt varrit dhe ju largon nga pallatet. Ju afron drejt vetimit me punët tuaja dhe ju largon nga kënaqja me familjen, fëmijët dhe pasurinë tuaj.

Robër të All-llahut! Pasha All-llahun dynjaja nuk mund të zhvillohet pa ngritjen e

fesë, nuk arrihet krenaria dhe epërsia pa nënshtrim ndaj Zotit të botërave, nuk vazhdon siguria, qetësia dhe komoditeti pa pasim të metodës së peygamberëve.

Ju them: nëse vazhdon muaji në dynja me mëkate dhe devijime, kjo është shkallëzim (istidraxh) të cilin e pason shkatërrimi dhe zëvendësimi. Andaj kapuni për respektet ndaj All-llahut nëse dëshironi të mbroheni nga denimi i Tij dhe pendohuni të gjithë, ju, te All-llahu, nëse dëshironi të shpëtoni.

All-llahu ynë të kërkojmë në këtë vend, duke dëshmuar se Ti je All-llahu, përpos të cilit hyjni tjetër nuk ka, Ti je Një dhe për ty kanë nevojë të gjitha krijesat, nuk lind dhe nuk je lindur dhe Ty nuk të ngjan askush, Ti që je Dhurues dhe Krijues i qiejve dhe tokës, Ti që je Pronar i shkëlqësisë dhe Nderit, Ti që je i Gjallë dhe Kujdestar, Ty të lytemi që të na e bësh këtë vit dhe vitin që vjen pas vite të sigurisë dhe qetësisë, vite të dijes së dobishme dhe veprave të mira, ku do ti derdhish mbi ne dhuntitë tuaja dhe do të na furnizosh falënderimin ndaj Teje. Vit ku do të përmirësosh përgjegjësit tanë. Vit ku do të shtyshë drejt udhëzimit dhe do të na sjellish te ne udhëzimin, Ti je Bujar dhe Fisnik, i Butë dhe i Mëshirshëm. Paqa dhe bekimi qofshin mbi robin dhe Pejgamberin Tënd, Muhammedin, mbi familjen dhe shokët e tij në përgjithësi....

-II-

...

Vëllezër të nderuar në xhumanë e kaluar u ngrit një njeri që dëgjonte hutben për tu falur, kurse unë e urdhërova që mos të falet, sepse njeriut nuk i lejohet të falet përderisa imami e mban hutben, përpos tehijetul-mesxhidit (namazit përshëndetës). Andaj nëse hyn njeriu, kurse imami është duke e mbajtur hutben, i fal dy rekate të shkurtra, siç ka urdhëruar Pejgamberi, sal-lall-llahu

alejhi ve sel-lem.

Disa njerëz nuk e panë këtë njeri dhe kanë menduar se unë e kam urdhëruar atë që ka hyrë në xhami mos ta fal te hijetul-mesxhidin, edhe pse dihet se unë në hutben e kaluar thash se njeriu kur hyn në xhami dhe imami është duke mbajtur hutben mos të ulet pa i fal dy rekate të shkurtra. Mirëpo disa njerëz i kuptojnë disa fjale e disa tjera nuk i kuptojnë, andaj e përsëris edhe një herë: kush hyn në xhami, kurse imami mban hutben, ai nuk ulet derisa ti fal dy rekate të shkurtra, kurse ai që ka hyrë dhe i ka falur dy rekate të te hijetul-mesxhidit, atij nuk i lejohet të falet gjatë hutbes, por duhet ta dëgjojë hutben.

Kujdes besimtar ndaj asaj që dëgjoni që mos ta kuptoni gabimisht, sepse këto gabime ndodhin shpesh. Njeriu duhet t'i kuptojë të gjitha aspektet e fjalës, fillimin, mesin dhe fundin që mos të gabon.

All-llahun e lus që të na dhurojë ruajtje të fesë, kuptim të shariatit dhe veprim sipas dijes që kemi, sepse ai është Bujar dhe Fisnik.

Dijeni vëllezër se fjala më e mirë është fjala e All-llahut, kurse udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Gjërat më të këqija janë të shpikurat. Keni frikë All-llahun o ju musliman dhe kapuni për udhëzimin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kapuni për të me dhëmballë dhe luteni Atë që t'ju përforcojë në këtë rrugë deri në vdekje që të ringjallen në shoqërinë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

O ju musliman dërgoni sa ma shumë salavate mbi Pejgamberin tuaj, sidomos në ditën e xhuma, sepse ai që dërgon mbi të një herë salavate, All-llahu dërgon mbi të dhjetë herë.

Robër të All-llahut! "All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërme, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim. Meqë keni premtuar, pra zbatoheni premtimin e dhënë ndaj All-llahut, e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar ato, duke qenë se All-llahun e bëtë garant tuajin. Vërtet, All-llahu e di se çka punoni". (En-Nahl: 90- 91).

Imam Muhamed Salih El-Uthejmin
Përktheu: Bekir Halimi
11.2.2005

Përfundimi i vitit dhe përfundimi i ymrit

Ditët kalojnë, hënat ndërrohen, vitet ikin, qefini përgatitet, veprat regjistrohen dhe dita e takimit dita ditës afrohet...

Për çdo ditë gjenerata vijnë në dynja dhe gjenerata ikin nga dynja...

Kurse shkujdesi i ka kapluar shumicën e zemrave të njerëzve, madje shumë njerëz sot, e shkatërrojnë ahiretin dhe e ndërtojnë dynjanë.

Sot, shumica e njerëzve nuk nervozohen

pse shkelen dispozitat e Zotit, mirëpo shumë hidhërohen nëse u merret ndonjë gjë nga dynjaja e tyre...

Tregtari i habitur pas tregtisë së tij dhe nuk shikon se si e fiton, me haram ose me hallall, nuk shikon as si e harxhon, në hallall ose në haram!

Nëpunësi zgjohet i trishtuar mos ka mbetur vonë për në punë, mirëpo rahat e rahat flenë nga punët e ahiretit!

Gratë, janë zhveshur nga petku i moralit dhe nderit dhe i bëjnë shumë vepra që e hidhërojnë All-llahun!

Gratë synim të vetmin të tyre kanë komoditetin e kësaj bote e aspak nuk interesohen për ahiret...

Brenga e Islamit dhe brenga për ahiret nuk ekziston në mendjen e shumë njerëzve të sodit...

Të paktë janë ata që nuk kanë rënë nën ndikimin e materializmit bashkëkohor.

Edhe më pak janë ata që janë të sinqertë dhe të vërtetë.

Vallë a ka kush merë mësim?!

Kaloi ky vit, sikurse ditët e këtij viti mos të kishin qenë asgjë.

Dymbëdhjetë muaj, filloi hëna e re e si fije, pastaj u bë pesëmbëdhjetëshe, pastaj filloi sërish të hollohet derisa u humb e tëra. Pastaj erdhën muajt tjerë, muaj pas muaji derisa erdhëm në fundin e vitit, dhe përfundoi edhe ky vit!

All-llahu ekber sa shpejt po shkojnë ditët!

Sa shumë bëhet mëkate!

Sa pak merret mësim!

Njeriu kalon nga kjo dynja ashtu sikur kalojnë edhe muajt.

Po të pyesim secili prej nesh dikën që është plak, për fëmijërinë e tij, ai do të tregojë se shumë shpejt ka kaluar, sikur të ishte dje, mirëpo akoma e ka shpresën e madhe.

I riu e ka harruar fëmijërinë dhe shpreson të jetojë gjatë, e kur plaket e qan rininë. Kështu është dynjaja, mirëpo ku janë të mençurit dhe ata që marrin mësim?!

A mjafton të jemi ymërgjatë?

Nuk duhet mbështetur në faktin se a jem ymërgjatë ose jo, por në veprat e mira që i veprojmë.

Vallë autoriteti i njerëzve qëndron me ta edhe në var?

Apo pasuria shkon dhe hyn me ta në var?

Shpëtimi është për atë që e përmirëson gjendjen e tij të brendshme dhe të jashtme dhe i përfundon ymri me vepra të mira.

Kurse humbja është për atë që brendësinë e ka rënuar dhe i përfundon ymri me vepra të këqija.

Njeri si të vdes ashtu edhe ringjallet, sepse transmeton Xhabiri radijall-llahu anhu, nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, i cili ka thënë:

"Ringjallet njeriu ashtu si ka vdekur". (Muslimi).

Këtë e dëshmon edhe hadithi të cilin e ka thënë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, për njeriun në ihrame, i nisur për në haxh, të cilin e rrëzoi deveja dhe vdiq:

"Do të ringjallet duke thënë telbijen (dmth: lebejke All-llahume lebejke). (Buhariu).

Dhe hadithi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, ku tregon se shehidi do të ringjallet me gjakun e plagëve në trup, ngjyra do të jetë ngjyrë gjaku, kurse aroma, aromë misku". (Buhariu).

Duhet të jemi të gatshëm të ballafaqohemi me vdekjen e mos të na befasojë, andaj duhet të qëndrojmë larg mëkateve dhe veprave të liga.

Frika e muslimanëve të parë nga përfundimi i keq

Muslimanët e parë, të cilët ishin shembull në dije dhe devotshmëri kishin shumë frikë të madhe nga përfundimi i tyre i keq.

Një natë qau Sufjan Theuri deri në mëngjes. I thanë: po qan për mëkatet që ke?

E mori një grusht dhe tha: mëkatet janë më të lehta se ky grushti i dheut, mirëpo qaj nga frika prej përfundimit të keq".

Ata El-Hafaf tha: Sufjanin çdo herë e kam takuar duke qarë. I thashë: çka ke? Tha: kam frikë mos vallë jam i regjistruar në Librin kryesor si fatzi".

Sehl Tusteriu thotë:

"Frika e njerëzve të vërtetë (sidikin) nga përfundimi i keq ekziston në çdo ide dhe çdo lëvizje. Ata janë ata që i ka përshkruar All-llahu duke thënë: "Zemrat e tyre i kanë në trishtim".

Shkaqet e përfundimit të keq

Prej shkaqeve më të mëdha për përfundim të keq është prishja e zemrës duke e prishur besimin, edhe në qoftë se pjesa e jashtme është në rregull. Kjo ndodh nëse njeriu bie në shirk ose vazhdon në bidate.

Shirku, idhujtaria e pengoi axhën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Ebu Talibin që ta thotë shehadetin në momentin e dergjjes. Kurse sa e sa bidatxhi u ka përfunduar jeta në mënyrë të keqe.

Bërja e mëkateve të mëdha dhe insistimi në mëkate ta prishin zemrën, lajmërojnë përfundimin e keq dhe fatzi.

Njeriu në momentin e dergjjes e përsërit atë që më shumë e ka thënë ose e ka vepruar, qoftë e mirë ose e keqe.

Sa e sa njerëz kanë vdekur ose duke pirë alkool, ose duke bërë zina, ose duke përdorur drogë, ose iu ka frenuar gjuha dhe nuk ka mund ta thotë as shehadetin. Zoti na ruajt.

Muxhahidi, rahimehull-llah, thotë: "Secili njeri që vdes, i paraqiten shokët me të cilët ka ndejtur".

Dijetarët përfundimin e keq e kanë ndarë në dy kategori:

1- Kategoria më e rëndë është rasti kur njeriu në grahamat e vdekjes fillon të dyshojë në Zot ose të mohojë Atë, e ti merret shpirti në këtë gjendje. Nuk ka dyshim se njeriu që shkon te Zoti në këtë gjendje, e pret dënimi i përhershëm dhe i dhembshëm.

2- Kategoria e dytë, e cila është më e lehtë se e para, është momenti kur ai është në grahamat e vdekjes ti shkojë ndërmend dashuria për ndonjë gjë të mirë të kësaj bo-

te ose për epsh. Ti paraqitet kjo para syve të tija dhe të ia kaplon tërë zemrën, saqë nuk i kujtohet asgjë tjetër përpos kësaj gjëje.

Vallë sa peshon dynjaja në zemrën tonë?!

Vallë, çka kemi bërë gati për në ahiret?!

Ne punojmë, lodhemi, rraskapitemi, vuajmë, qëndrojmë, mirëpo vetëm për jetesën e kësaj dynjaje, kurse ahiretin e kemi harruar tërësisht. Edhe nëse i kryejmë disa adhuri-me, ato nuk kanë shije, nuk kanë kënaqësi dhe nuk ofrojnë prehje. Sepse tërë kënaqësia, shija dhe prehja na ofrohet kur fitojmë pasuri, ose autoritet ose pozitë.

Fatkeqësia më e madhe është kur një njeri vepron vepra të mira, mirëpo është regjistruar në librin e të fatzinjve. Njerëzit e shohin duke bërë mirë dhe ia kanë lakmi, mirëpo nuk ia dinë nijetin e tij të prishur, brendësinë e kalbur dhe syefaqësinë në veprat e tija.

Sehl ibën Sadi, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u takua me idhujtarët dhe luftoi me ta. Kur u kthye Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në kampin e tij dhe të tjerët shkuan në kampin e tyre, mbeti një njeri prej shokëve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili nuk linte askënd që kishte mbetur mbrapa ushtrisë idhujtare e mos ta godiste me shpatë. Sahabët thanë: askush nuk ka luftuar sikur ky njeri. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: "Ai është prej banorëve të xhehenemit".

Një njeri prej nesh tha: unë do ta shoqëroj vazhdimisht. Doli me te. Kur ecte, ecte edhe ky, kur ndalej, ndalej edhe ky dhe kur nxitonte, nxitonte edhe ky. Ky njeri tregon: u plagos ky njeri me një plagë të rëndë. E shpejtoi vdekjen duke e venduar dorezën e shpatës në tokë kurse majën e shpatës në gjoks, pastaj u lëshua mbi shpatë dhe e

mbyti vetveten. Ky njeri erdhi me vrap te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: dëshmoj se ti je i Dërguar i All-llahut. I tha: çka ndodhi? Tha: njeriu për të cilin the se është banor i xhehenemit dhe njerëzit u habitën me këtë lajm. Unë e përcjella atë derisa u lëndua rëndë. E kur u lëndua e shpejtoi vdekjen duke e venduar dorezën e shpatës në tokë, kurse majën e saj në gjoks dhe u lëshua mbi shpatë dhe e vrau vetveten. Atëherë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: "Ndodh që ndonjë njeri të veprojë me vepra të banorëve të xhennetit, ashtu si i duket njerëzve, kurse është prej banorëve të xhehenemit. Ndodh që ndonjë njeri të veprojë me vepra të banorëve të zjarrit, ashtu si i duket njerëzve, mirëpo është prej banorëve të xhennetit. Veprat vlerësohen sipas fundit". (Muslimi).

Rëndësia e përmirësimit të zemrës dhe veprave

Vendi i varrosjes, momenti i vdekjes, numri i atyre që ta përcjellin xhenazen, as nuk ti shtojnë të mirat e as nuk i pakësojnë të këqijat.

Mund që këto raste të jenë shenjë e mirësisë dhe argument i shpëtimit, siç është dëshmia e burrave të devotshëm për ndonjërin se është i mirë, sepse ata janë dëshmitarët e All-llahut në tokë, mirëpo kryesorja është përmirësimi i zemrës dhe pranimit i veprave.

Nuk ka dyshim se njerëzit gjykojnë sipas asaj që shohin, kurse zemrat i di vetëm All-llahu, subhanehu ve teala.

Vendi nuk e shenjtëron askënd, por ajo që e shenjtëron dikën është puna që bën, siç ka thënë Selman Farisiu.

Sa njerëz adhuroes të mëdhenj kanë

shndrit nga adhurimi, janë parë gjurmët e vullnetit dhe lumturisë, ka fituar famë dhe autoritet, mirëpo ka vendosur Caktimi që të kthehet mbrapa, dhe t'i përfundojë ymri me vepra të këqija.

Është e ditur se nuk mund të ketë përfundim të keq ai që e ka të shëndoshë zemrën dhe gjymtyrët i zbatojnë obligimet që ka ndaj Zotit.

Kurse ai që ka zemrën e prishur dhe insiston në mëkate të mëdha, atij mund ti ndodh që mos të pendohet para vdekjes dhe të shkon te All-llahu me mëkate të mëdha.

Ndodh që ndonjë njeri e kaplon ndonjë mëkat, ose ndonjë refuzim, ose ndonjë shpifje, e cila ia pushton zemrën dhe ia robëron mendjen, andaj këtij nuk i bën dobi as përkujtimi, as këshilla, kurse në momentin e agonisë së vdekjes i vjen shejtani dhe ia merr besimin.

Besimtari duhet të kujdeset për përmirësimin e zemrës së tij, të nxitojë në fitimin e kënaqësisë së Zotit të vet dhe ta lute Atë që ti ofrojë përqendrim në rrugë të drejtë deri në vdekje, sepse zemrat janë mes dy Gishtave të All-llahut, i ndërron si dëshiron Ai.

Me përfundimin e këtij viti, vallë kemi marrë mësim nga ajo që kaloi?!

A nuk kemi frikë nga përfundimi i keq?!

Pse mëkatari nuk nxiton të pendohet te All-llahu dhe ti rreket veprave të mira?!

Ndoshta All-llahu ia pranon pendimin dhe e regjistron në mesin e njerëzve të lumtur, sosh i cili asnjëherë më nuk do të vuan.

All-llahun e lusim të na përmirësojë zemrat dhe vepra, të na dhuroi përfundim të mirë dhe të na bëjë nga ata që i ka pranuar dhe me të cilët është i kënaqur.

Përgatiti: Bekir Halimi
18.2.2005

Para se të përmytet barka

As'hab es-sebt, njerëzit e ditës së shtunë. Ata ishin një grup njerëzish nga Beni Israilët të cilët ishin sprovuar në ditën e shtunë, ditën kur ata duhej ti linin punët e dynjasë dhe ti luteshin Allahut. Gjithë javën ata do të peshkonin, por rrjetat do tu dilnin bosh. Por të shtunave, kur nga ata kërkohet të linin punët e tyre, peshku do të dilte me bollëk. Një sprovë nga Allahu!

“Ne ngritëm mbi ta (bregun) Tur'in pse ishin zotuar (ta pranojnë Tevratin)' u patëm thënë: “Hyni në derë (të bejtul mukadesit) të përulur, dhe u patëm thënë: “Mos e thyeni të shtunën” (mos gjuani peshk). Ashtu Ne patëm marrë prej tyre besë të fortë”. [en-Nisa:154]

Një grup prej tyre u bënë transgresorë, të pakënaqur me urdhrat e Allahut, ata ndërtuan një skemë për ta kapërcyer urdhrin. Ata t'i hidhnin rrjetat e tyre të premtën dhe pastaj të dielën do të shkonin të merrnin peshkun që mbetej në to.

Banorët tjerë u ndanë në dy grupe kur ata e panë të keqen e madhe dhe gjynahun në të cilin kishin rënë. Njëri grup prej tyre u përpoq t'i këshillonte transgresorët dhe për t'i paralajmëruar ata nga pasojat e tmerrshme të veprave të tyre, duke urdhëruar për të mirën dhe duke e ndaluar të keqen.

Duke menduar që ata nuk kishin përgjegjësi për çfarë ishte duke ndodhur, një grup tjetër e mbante mendjen vetëm tek punët e tyre, duke ju përmbajtur mendimit që Allahu si rrjedhim do t'i shkatërrojë gjynahçarët.

“Dhe kur një grup prej tyre thanë: “Përse këshilloni një popull që All-llahu do ta shka-

tërrojë ose dënojë me një dënim të ashpër?”...” (A'raf: 164)

Dëgjoni me kujdes sesi është përgjigja e atyre thirrësve në bindjen ndaj Allahut:

“...Thanë (këshilluesit): “Arsyetimi para Zotit tuaj dhe me shpresë që t'ju largohen gabimeve”. (A'raf: 164)

Kjo është për dy arsye:

Një, që ne do të na falë Allahu për shkak se u përpoqëm t'i ndalonim ata.

E dyta, që ndoshta ata mund të dëgjojnë përkujtuesin dhe të kthehen, tek Allahu.

Vetëm ky grup shpëtoi.

“ E kur braktisën atë për të cilën ishin këshilluar, Ne i shpëtuam ata që pengonin nga të këqijat, ndërsa ata që kundërshtuan i kapëm me një dënim të fortë, ngase ishin të shfrenuar.

E kur ata tejkaluan me arrogancë të hapët, nga ajo që ishin të ndaluar, Ne i shndërruam në majmunë të përbuzur.” (A'raf: 165-166)

Në një natë, ndëshkimi ra përmbi ta dhe ata u shndërruan në derra dhe majmunë.

Të dashur vëllezër dhe motra, është nga natyra e qenies njerëzore ndierit e nevojës për të bërë mirë ose për të ndjerë dëshirën për të rënë në gjynah. Madje edhe nëse ai ose ajo do të ishin vetëm, të braktisur dhe të izoluar, ata ende do ta ndjenin dëshirën për të bërë mirë dhe për tu angazhuar në të keqen.

Ummeti musliman ka një karakteristikë që jo vetëm duhet t'i bëjë mirë vetvetes por duhet të inkurajojë edhe të tjerët të bëjnë mirë, ne duhet të bëhemi një forcë që lëviz.

Dhe ne nuk duhet vetëm të largohemi nga gjynahet por edhe duhet t'i ndalojmë të tjerët nga të vepruarit kështu, ne duhet të bëhemi pengesa.

Nëse ne të gjithë do të kishim karta muslimane identifikimi, do të duhej të kishte në te përshkrimin e personit. Nëse do të ishte një kartë e vlefshme në te si përshkrimi do të shkruhej: "Ky burrë/grua urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja, sepse kështu na ka përshkruar Allahu neve.

"Ju jeni njerëzit më të mirë që janë ngritur ndonjëherë për njerëzimin, ju urdhëroni el-Maruf (të mirë) dhe ndaloni el-munker (të keqen) dhe ju besoni tek Allahu". [Ali-Imran:104]

E mira dhe e keqja. Kur vjen fjala tek inkurajimi i njerit apo tjetrit, ka dy grupe njerëzish. Të parët janë ata që i inkurajojnë të tjerët të bëjnë mirë dhe i këshillojnë ata të ndalohen nga të bërit keq. Këta janë muminunët (besimtarët) dhe Muminat (besimtare), ata të cilët do të favorizohen nga mëshira e Allahut:

"Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë". [et-Teube:71]

Grupi i dytë i njerëzve janë ata që inkurajojnë të tjerët drejt të keqes dhe i ndalojnë ata kurdo që i shohin se janë duke bërë vepra të mira (të virtutshme). Këto janë munafikun (hipokritët) dhe munafikat (hipokritet), ata janë ata që Allahu do t'i shkatërrtojë:

"Hipokritët dhe hipokritet janë si njëri tjetri; urdhërojnë për të keqen e ndalojnë nga e mira dhe shtrëngojnë duart e tyre. Harruan All-llahun (nuk i binden), prandaj Ai i harroi

(nga mëshira). Nuk ka dyshim, hipokritët janë ata të prishurit". [et-Teube:67]

Kur'ani na tregon që fituesit, ata që do të arrijnë suksesin janë ata muslimanë burra dhe gra që do të urdhërojnë për mirë dhe do të ndalojnë nga e keqja. Dhe Allahu na mëson ne që Ai i ka mallkuar popujt përpara nesh sepse ata humbën këtë karakteristikë të inkurajimit të të mirës dhe ndalimit të së keqes:

"Ata që mohuan të vërtetën nga beni israilët, u mallkuan prej gjuhës së Davudit dhe të Isait, të birit të Mejremes. Kështu u veprua sepse kundërshtuan dhe e tepruan. Ata ishin që nuk ndalonin njëri-tjetrin nga e keqja që punonin. E ajo që bënin ishte e shëmtuar". [el-Maide: 78-79]

Kur një popull dështon në detyrën për të urdhëruar për të mirë dhe për të ndaluar të keqen, lutjet e tyre nuk i pranohen.

Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Për Atë i cili mban shpirtin tim në Dorën e Tij, ju o do të urdhëroni për të mirë dhe të ndaloni nga e keqja ose ndryshe Allahu do të hedh mbi ju një ndëshkim, atëherë nëse ju do të përpiqeni t'i luteni Atij, lutjet tuaja nuk do tu përgjigjen". [transmetuar nga Ahmedi dhe et-Tirmidhi]

Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka jetuar tërë jetën e tij duke urdhëruar për të mirë dhe duke ndaluar të keqen. Kur ai së pari arriti në Medine, gjëja e parë që ai i tha ensarëve dhe muhaxhirëve ndërsa ata u grumbulluan për të parë fytyrën e tij të nderuar ishte:

Abdullah Ibën Selam ka transmetuar që kur Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, erdhi në Medine, njerëzit vrapuan ta përshëndetnin atë. Unë shkova në turmën për ta parë atë dhe kur e pashë fytyrën e tij unë e dija që fytyra e tij nuk ishte fytyra e një gënjeshtari. Gjëja e parë që ai tha kur ai

i foli njerëzve ishte: "O njerëz, përhapni selamin, ushqeni të uriturit dhe faluni natën kur të tjerët janë duke fjetur dhe ju do të hyni paqësisht në xhennet". [transmetuar nga Ibën Maxhe]

Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, do të urdhëronte për të mirë dhe do të ndalonte nga e keqja në të gjitha kategoritë e shoqërisë. Ne e shohim atë me të rinjtë muslimanë duke i këshilluar ata, si në hadithin që vijon:

Omer Ibën Ebu Seleme ka thënë: "Unë isha një djalë i ri nën kujdesin e Të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kur duart e mija ishin duke kërcyer këtu dhe atje për të marrë ushqimin në pjatë. I dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, më ka thënë: "O djalosh, thuaj bismilah (së pari), ha me dorën e djathtë dhe ha nga ajo që ke përpara teje". Ibën Ebu Seleme ka thënë: Pas kësaj unë gjithmonë hëngra në atë mënyrë (në të cilën më është treguar)". [Buhari dhe Muslim]

Dhe Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, inkurajonte të mirën midis grave muslimane. Zejneb, gruaja e Abdullah Ibën Mesudit ka thënë: "I dërguari i Allahut na është drejtuar neve: "O gra, jepni lëmoshë madje dhe për sendet e juaja të çmueshme". [Buhari dhe Muslimi]

Madje edhe kur biente fjala për gratë e tij, Resulullahi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, do të ndalonte të keqen. Aisheja, radijallahu anha, vetë na transmeton një hadith që ajo njëherë i ka thënë atij, sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Shiko për Sefijen", duke nënkuptuar me këtë faktin që ajo ishte e shkurtër. Kështu i dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka thënë: "Ti ke thënë një fjalë që nëse do të përzihej me të gjithë ujin e një deti do ta përpinte ujin". [transmetuar nga Ebu Davud]

Aisha ka thënë që pasi që e ka dëgjuar këtë ajo kurrë nuk ka dashur më të përmendte dikën (me diç që ata nuk do ta pëlqenin)

Kjo është çfarë feja thotë, për urdhërimin e të mirës dhe ndalimin e të keqes. Kjo është çfarë muslimanët e parë bënë në betimin e aleancës (bej'a):

Ubade Ibën Es-Samit, radijallahu anhu, ka thënë: "Ne i dhamë besën tek i dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, për të dëgjuar dhe për tu bindur (itaat) në ate që ne pëlqejmë dhe në atë që ne nuk pëlqejmë dhe që ne nuk i prekim njerëzit në nder dhe që ne do të qëndrojmë për të vërtetën kudo që të jetë, duke mos u frikësuar, për hir të Allahut, asnjë qortimi nga qortuesit". [Buhari dhe Muslim]

II

Dijetari el-Harithi, rahimehullah, shkante tek dyert e vendeve ku kryheshin të këqija dhe i paralajmëronte njerëzit për gjynahet që ata ishin duke i bërë. Ata do ta rrihnin atë me grushte derisa ai do të binte pa ndjenja, i larë në gjak. Por ai kurrë nuk do të kalonte pranë tyre pa i këshilluar. [nga Sijar el-Alam nga Imam eDh-Dhehebi]

Unë kujtoj njëherë në një shkollë islame kur një djalë erdhi dhe më tregoi mua se çfarë ai do të merrte për ditëlindjen e tij. Unë isha i habitur, përderisa ditëlindjet nuk janë diçka që ne e gjejmë në mënyrë tonë të jetesës, islam, diçka që ne nuk duhet të marrim pjesë. Shokët e klasës e dinin gjykimin mbi ditëlindjet kështu ata filluan të këndonin me zë të lart: "S'ka më ditëlindje, S'ka më ditëlindje".

I dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, na ka dhënë ne një parabolë që ne kurrë nuk duhet ta harrojmë në këtë çështje të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e

keqja. Numan Ibën Beshir, radijallahu anhu, ka transmetuar që: "Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Shembulli i atij i cili është i vendosur në kufijtë e Allahut dhe atij që i ka kaluar këta kufij është sikur shembulli i disa njerëzve në një bark. Ata poshtë (barkës), në mënyrë që të pinin kishin nevojë të shqetësonin ata që ishin lart. Kështu ata i thanë vetëve të tyre, le të bëjmë një vrimë poshtë (barkës) në këtë pjesën tonë që të shqetësojmë ata që janë sipër". Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka vazhduar: "Nëse ata (që janë sipër) i lënë ata (që janë poshtë) të bëjnë se çfarë duan, ata do të mbyten të gjithë. Dhe nëse ata i ndalojnë ata (që janë poshtë) ata (që janë lart) do t'i shpëtojnë njerëzit poshtë (barkës) dhe të gjithë ata do të shpëtojnë". [Buhari]

Kur dikush inkurajon të mirën dhe ndalon të keqen ai duhet të ketë disa karakteristika:

1. Dija.
2. Durimi, ashtu siç Llukmani i ka treguar djalit të tij.
3. Ai duhet të jetë i drejtë, duke mos harruar të mirën që ai person ende e ka.
4. Hikmetin, urtësia.
5. Këndshmëria ndaj atyre të cilët janë duke i këshilluar.

Domethënia e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit të keqes është që të mos tregohet zemërim në zemrat tona apo hakmarrje të një fyerje ndaj nesh. Në fund ne duam personin që të udhëzohet, një gjë kjo që

kërkon nga ne të gëlltisim krenarinë personale. Në disa kohëra, kur situata e kërkon atë, ne mund të fyejmë ndjenjat e dikujt nëse ajo është e vetmja mënyrë me të cilën ata mund të udhëzohen. Por kjo vlen vetëm për personin që ka IIm (dije) dhe Hikmet (urtësi) që mund ta analizojë situatën.

Fyerja e ndjenjave të muslimanëve të zakonshëm nuk është mjeti, e as poshtërimi publik i dikujt i cili vjen në xhami për herë të parë. Ka metoda të atyre të cilët nuk janë të shkolluar mirë që kur thërrasin për tek Allahu (bëjnë davet) e që bëjnë shumë dëm.

Në përfundim, ka shumë mënyra sesi dikush mund të inkurajojë të mirën dhe të ndalojë të keqen, ja disa:

-Me një broshurë që thekson çfarë është e nevojshme për të inkurajuar ose me një email të përgjithshëm.

-Me një kasetë, CD islam që i jepet si dhuratë.

-Me një revistë islame ose gazetë.

-Me një email ose letër që adresohet në mënyrë të veçantë me atë person i cili ka nevojë për të inkurajuar apo nevojën për të këshilluar në largimin nga gjynahet.

Dhe lista vazhdon më gjatë...

Ju dëshironi të jeni të suksesshëm, apo jo? Mirë, atëherë kjo është rruga:

"Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit". [Ali-Imran:104]

Muhammed Sherif
(pjesë nga transkriptimi i një hutbeje të mbajtur në xhami)
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
4.3.2005

Hyrje në shkencat e Kur'anit

Kur'ani është Fjalë e All-llahut e zbritur (pejgamberit të fundit) Muhamedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, me anë të vahjit (shpalljes) leximi i së cilës është adhurim.

Kur themi për Kur'anin se është fjalë e All-llahut aludojmë në atë se në këtë Libër nuk ka fjalë të ndonjërit tjetër përpos të All-llahut, absolutisht. Muhamedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, vetëm e ka kumtuar atë që iu shpall nga All-llahu.

Gjithashtu në përkufizim kemi cekur se Kur'ani i është zbritur Muhamedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, me anë të vahjit – shpalljes. Pikënisja e kësaj shpallje ka shënuar pejgamberinë, atë se Muhamedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është i dërguar i All-llahut.

All-llahu i madhëruar ka thënë në Kur'anin Fisnik:

"Nuk ka asnjë njeri që t'i ketë folur All-llahu ndryshe, vetëm se me anën e frymëzimit (vahjit), ose pas ndonjë perdeje, ose t'i dërgojë të dërguar (melek) e ai t'i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai. Vërtetë Ai është më lart, më lurti." (Shura-51)

Çfarë nënkuptojmë me vahjin, shpalljen?

Fjala "vahj" është fjalë arabe në infinitiv që përmban dy domethënie: shpejtësi dhe fshehje. Ajo që i është shpallur Muhamedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nga vahji ka ngjarë në disa mënyra siç na tregon nëna e besimtarëve Aisheja, radijallahu anha, në hadithin që e transmeton Muslimi në sahihun e tij:

- Gjëja e parë që filloi nga vahji Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ishte ëndrra e vërtetë në gjumë. Nuk shihte ëndërr pa i ardhur (e qartë) si aurora e mëngjesit, pastaj iu bë e dashur vetmia dhe vetmohej në shpellën Hira ku bënte adhurim ..., derisa i erdh e vërteta duke qenë në shpellën Hira, i erdh meleku dhe i tha: lexo! ...

Nga ajeti i lartpërmendur dhe hadithi i Aishes, radijallahu anha, nënkuptojmë se vahji ka pasur mënyra të ndryshme:

E para: ëndërr

E dyta: t'i vjen meleku – Xhibrili.

E treta: pas perdes

Forma e dytë – ti vjen meleku, i ka dy lloje.

a-Lloji i parë është kur dëgjon zë si cingërima e ziles.

b-Lloji i dytë është kur meleku shëndërohet / paraqitet në formë të njeriut.

Këto dy lloje janë të përmendura te hadithi që e transmeton Buhariu dhe të tjerë nga Aisheja nëna e besimtarëve se Harith ibën Hishami, radijallahu anhu, e ka pyetur të dërguarin e All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem:

- O i dërguar i Allahut, si të vjen vahji? I dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha: - Ndonjëherë më vjen si cingërima e ziles (salsaletul-xheres) dhe kjo është më e vështira për mua, pastaj ndahet nga unë e unë, vetëm se e kam kuptuar çka ka thënë. Ndonjëherë meleku më shëndrohet në formë të njeriut dhe më flet e unë e

kuptoq atë që më thotë.

Këto dy llojet nga mënyra e dytë e vahjit janë kryesisht ajo që i ka takuar shpalljes së Kur'anit sepse me mënyrat tjera janë shpallur edhe hadithi kudsî dhe ai nebevi.

Pasi që flasim për Kur'anin, përqendrohemi në këto dy lloje të vahjit kur meleku kontakton me të dërguarin e All-llahut. Kjo ka ndodhur siç përmendëm më sipër se i dërguari, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dëgjon vetëm zë dhe atë si cingërima e ziles dhe se kjo ka qenë nga më të vështirat. Pohohet se meleku në këtë lloj të vahjit vjen në formën e vet, por mbetet i padukshëm dhe dëgjohe vetëm zë që shkakton vështirësinë ose vetë shpallja - fjala e All-llahut është e rëndë dhe vështirë për tu pranuar. All-llahu i madhëruar ka thënë në Kur'an:

"Ne do të shpallim ty fjalë të rëndë " (Muzemil-5)

Transmeton Buhariu nga Aisheja radijallahu anha, që thotë: - e kam parë (të dërguarin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem) duke i zbritur vahji në ditë të ftohtë, acar, dhe pas ndërprerjes, balli i kullonte djersë.

Po ashtu edhe raste tjera si rasti kur i ka ardhur shpallja duke qenë i hipur mbi kafshë e ajo ka rënë në gjunjë. Një herë tjetër kur i ka ardhur shpallja e ka pasur kofshën të mbështetur te kofsha e Zejd ibën Thabitit. Pothuajse ia ka shtypur si petë.

Zbritja e Kur'anit

Në disa ajete në Kuran ceket se Kur'ani ka zbritur i kompletuar në Natën e Kadrit. All-llahu i madhëruar ka thënë:

"Ne ta zbritëm ate (Kur'anin) në natën e Kadrit " (Kadër- 1)

Nga biografia e të dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e dimë se Kurani është shpallur në periudhë prej njëzet e tre vjetësh. Këtë e sqaron Ibën Abasi, radijallahu anhu.

Transmetohet nga Ibën Abasi, radijallahu anhu, në disa transmetime se Kurani së pari ka zbritur i plotë në qiellin e dynjasë në Bejtul-'Izzeh e pastaj nepërmjet Xhibrilit i është shpallur Muhamedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në një periudhë njëzet e tre vjeçare. Për këtë dëshmon edhe ajeti:

"Dhe Kur'anin e ndamë (pjesë-pjesë) për tua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe e kemi zbritur me zbritje të njëpasnjëshme ". (Isra-106)

Këtë qëndrim e kanë pjesa dërmuese e dijetarëve.

Kohëpaskohe, Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i shpallëshin pjesë nga Kur'ani Famëllartë, ajete apo sure të plota. Në fillim, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nga frika se mos po harron nga ajo që po i shpallet, filloi ti përsërisë shpesh dhe me shpejtësi ajetet dhe suret që iu ishin shpallur. All-llahu i madhëruar zbriti ajetin:

"Mos e lëviz gjuhën që të shpejtosh me të (Kur'anin). Se neve me të vërtetë na takon tubimi dhe recitimi i tij. E ne kur ta lexojmë, ti përcjelle leximin e tij. E pastaj ne e japim sqarimin ". (Kijame 16 - 19)

Kësi mbrojtje dhe garanci, All-llahu i Madhëruar i dha Kuranit edhe me ajetin:

"Me të vërtetë Ne e kemi zbritur përmendjen (Kur'anin) dhe Ne gjithsesi do ta mbrojmë ate". (Hixhër 9)

Së pari Kur'ani zbriti pjesë-pjesë deri sa u plotësua. Kjo mënyrë ishte lehtë për të Dërguarin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe shokët e tij, sahabët, që ata ta mësojnë Kur'anin përmendësh. All-llahu i Madhëruar ka thënë:

"Ne Kur'anin e bëmë të lehtë për kujtesë ..." (Kamer-17)

Kur'anin e lexonin për ditë dhe leximi i Kuranit është kusht i namazit që e falnin pesë herë në ditë. Por nuk ishte vetëm kjo.

Në mesin e sahabeve kishte një numër i caktuar që e shkruanin shpalljen. Kur përmendëm format e vahjit, përmendëm se njëra nga ata ishte të dëgjon zë si cingërima e ziles. Këtë e dëgjonte vetëm i Dërguari, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ndërsa sahabet kanë dëgjuar zë si zukama e bletës. Kur kanë dëgjuar këtë zë e kanë ditur se po i shpallet dhe me gatishmëri kanë pritur se çka po i shpallet. Pasi u recitonte shpalljen, ata e shkruanin e pastaj i pyeste se çka kanë shkruar që mos të pëson ndonjë ndryshim. Kështu deri sa u plotësua shpallja, regjistrimi i Kur'anit pati kontroll absolute. Pas plotësimit të shpalljes, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ndërron jetë kurse Ku'anin sahabët e dinin përmendësh dhe një numër i konsideruar e kishin të regjistruar. Edhe Allahu në disa ajete Kur'anin e përmendë me emrin Libër si p.sh.:

"Elif, Lam, Ra. Këto janë Ajetet e Librit, të Kur'anit të Qartë". (Hixhër 1)

Kurani ishte i regjistruar por nuk ishte i tubuar në një vend. Tubimi i Kur'anit u bë në periudhën e Halifes, Ebu Bekër. Shkak për këtë ide ishte beteja e Jemames në v. 12 h. ku ranë dëshmorë (shehidë) shtatëdhjetë nga sahabët që ishin hafizë të Kur'anit. Kjo e frikësoi Omerin, radijallahu anhu. Ai vajti te Ebu Bekri, radijallahu anhu, dhe ia përmendi këtë rast dhe i thotë se mundë të ndodhin kësisoj betejash e të humbin jetën shumë nga hafizët e Kur'anit. Për këtë shkak e luti që të pranon ta tubojnë Kur'anin në një vend. Ai në fillim nuk pranoi duke thënë se si ti bën një gjë që nuk e ka bërë i Dërguari, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Omeri, radijallahu anhu, vazhdoi ti fletë për këtë çështje Ebu Bekrit deri sa All-llahu ia hapi gjoksin dhe pranoi. E thërrasin Zejd ibën Thabitin dhe e autorizojnë atë për këtë punë të rëndësish-

me në historinë Islame.

Zejd ibën Thabiti së pari u mbështet në atë që dinin përmendësh e pastaj ua pranonte atë që sillnin të shkruar, me dëshmitarë.

Kështu në këtë mënyrë u tubua Kurani në periudhën e Ebu Bekrit dhe mbetet te ai deri sa ndërron jetë në vitin 13 h. Pastaj mbetet te Omeri, radijallahu anhu, derisa edhe ai vdes. Pas vdekjes tij mbetet te bija e tij Hafsa, radijallahu anha.

Kufiri i shtetit Islam vazhdimisht zgjerohej dhe sahabet shpërndaheshin nëpër vende të ndryshme. Pasi që Kur'ani kishte zbritur në shtatë dialekte, (harf=lexim, dijalekt) kishte mënyra të ndryshme të leximit. Secili që kishte shkruar në një anë të botës, atje kishte përhapur atë lloj të leximit. Kjo shkaktoi huti te ata të huaj që nuk e dinin këtë.

Në betejat e Ermenisë dhe Azerbejxhanit mori pjesë sahabi i njohur Hudhejfe ibën Jemani i cili vërejti kontradikta të shumta në mënyrat e leximit të Kur'anit. Lexim të parregullt, ndalje jo me vend derisa edhe e paditnin njëri-tjetrin me kufër. Hudhejfe brengoset shumë dhe i gajluar shkon te Othman ibën Afani (halifeja i atëhershëm) dhe i rrëfen gjendjen që kishte parë. Othman ibën Afani menjëherë merr iniciativë për ta shëruar këtë gjendje kaotike dhe i thërret hafizat dhe ekspertët nga sahabët që ta shkruajnë Kur'anin. E marrin nga Hafsa Mus'hafin e tubuar në kohën e Ebu Bekrit dhe e përshkruajnë në disa kopje në mesin e sahabëve më eminent. Pastaj i shpërndau nëpër vende të ndryshme dhe një e ndali në Medine. Këtë Kur'an të tubuar e quajnë Mus-haf Imam. Ky është mus-hafi në të cilin janë bashkuar muslimanit duke i ruajtur edhe dialektet tjera të Kur'anit.

Përshkrimi dhe radhitja e Kur'anit që u bë në kohën e Othmanit, radijallahu anhu, e

ka pasur formën e Kur'anit që sot e kemi para duarve tona.

Kurani është mrekullia - muzhizeja e përjetshme që vazhdimisht sfidon dhe nuk ka konkurrent. Mrekullitë në Kur'an janë të ndryshme. Gjuhësore, ligjore, shkencore dhe në gjithë sferat e jetës. Mrekullia e Kur'anit si e tërë është mrekullia gjuhësore, stilistika me radhitjet e fjalëve në fjali. Kur arabët kishin arritur kulminacionin e përsosjes së gjuhës arabe dhe thurnin vargje me stil të lartë, erdh Kur'ani i sfidoi dhe triumfoi. Në çast mbeteshin të habitur kur dëgjonin pjesë nga Kur'ani. Fascinohehin me përmbajtjen dhe stilin që kishte. Si mos të jetë kështu pasi që Kur'ani është nga All-llahu - Krijuesi I botëve. A thua vallë

krijesa do të garon me Krijuesin?! All-llahu I madhëruar ka thënë:

"Ha, Mim. Zbritja e Librit (Kur'anit) është prej All-llahut të, Gjithëfuqishmit të Urtit " (Xhathije 1-2)

Emrat dhe cilësitë e Kur'anit

Para së gjithash emër i parë i këtij libri qiellor është Kur'an, libër që ka tubuar shumë gjëra dhe shumë lexohet. Emrat tjerë të tij janë; El-Furkan, (Dalluesi), Et-Tenzilu (Libri i Zbritur), Edh-Dhikru (Përmen-dja, këshilla), El-Kitabu (Libri), etj.

Nga cilësimet e Kur'anit janë; Nurun (Dritë), Huden (Udhëzues), Rahmetun (Mëshirë), Shifaun (Shërim), Mev'idhatun (Këshillë), Mubarekun (I Begatshëm), etj.

Ali Shaban Tanusha,
11.2.2005

Besimi në Ditën e Gjykimit

Besimi në Ditën e Gjykimit është njëra nga gjashtë shtyllat e imanit (besimit islam), pa të cilin nuk është i saktë besimi i muslimanit. Ajo është që lë gjurmë në jetë, sikurse në nënshtrimin ndaj Allahut, lënien e së ndaluarës, përmirësimin e zemrës, fitoren në këtë dhe botën tjetër. Gjithashtu edhe harrimi i kësaj Dite të Madhe dhe pakujdesia ndaj saj, është e rrezikshme për njerëz dhe ardhmërinë e tyre. Edhe nuk është rastësi që Allahu këtë Ditë e përmend në shumë ajete kuranore, për më tepër, pothuajse nuk ka faqe në Kuran në të cilën nuk është e përmendur. Nëse e dimë që Allahu xhele sha'nuhu dhe i Dërguari i Tij salallahu alejhi ue sellem, kanë vënë theks

në këtë Ditë në të cilën do të grumbullohen të gjitha krijesat qiellore dhe tokësore, atëherë pse ne si robër të Allahut dhe pasues të Pejgamberit salallahu alejhi ue sellem, jemi të pakujdesshëm ndaj saj? Pyetjet më të rëndësishme rreth së cilave gjithsesi do të duhej të merreshim secili nga ne janë: "Për çka ekzistoj në këtë botë?", "çfarë është ardhmëria ime?", "cilat janë shkaqet e fatit dhe fatkeqësisë sime?". "A ka diçka më të keqe se ajo që njeriu ta shkatërroj veten dhe familjen e tij në Ditën e Gjykimit?"

Rëndësia e kësaj teme shihet në:

1. Kjo botë u është hapur shumicës së njerëzve, posaçërisht në këto kohë, natë e ditë dhe në çdo mënyrë luftojnë për të. E

kanë zbuluar para syve të njerëzve, duke i larguar nga ajo botë dhe devotshmëria në të cilën kanë qëndruar sahabet e Pejgamberit salallahu alejhi ue sellem. Ai, salallahu alejhi ue sellem, shpesh ua ka tërhequr vëmendjen në pavlefshmërinë e dynjallëkut dhe në rëndësinë e përgatitjes për botën tjetër. Duke u nisur nga fakti se dynjallëku para tyre nuk ka qenë i hapur sikurse është para nesh, atëherë ne kemi nevojë më tepër se ata në përkujtimin e seriozitetit të ahiretit dhe përgatitjes për të.

2. Lidhja e madhe për dynjallëk me vete tërheq ngurtësinë e zemrës dhe largimin nga Libri i Allahut, të cilin e lexojmë pa meditim. Ku janë ato zemra të cilat dridhen kur përmendet Allahu, ndërsa sytë vesojnë. Gjithashtu, cili nga ne e kryen namazin me nënshtrim dhe frikërespekt. E lusim Allahun të na ndihmoj!

3. Përkujtimi në Ditën e Gjykimit dhe në vështirësitë e saj, njeriun e nxisin në vepra të mira dhe lënien e veprave të liga, në anën tjetër, të harruarit e saj shkakton kryerje me dembel-lak dhe në mënyrë të pakujdesshme të obligimeve fetare, e për vepra vullnetare as të mos flasim.

4. Në këtë kohë janë paraqitur shumë sëmundje shpirtërore dhe të zemrës, të cilat shpijnë pikëllim dhe në humbje të shpresës në mëshirën e Allahut, ndërsa shkak për këtë është harrimi i Allahut dhe Ditës së Gjykimit.

5. Në shumë vende është paraqitur padrejtësia, armiqësia ndërmjet njerëzve,

marrja e padrejtë e pasurisë së huaj, lloj-lloj mashtrimesh, urrejtja, zilia, kundërshtimet, e sidomos ndërmjet thirrësve dhe studentëve të shkencave islame. Ilaçi më i mirë për këtë është përkujtimi i Ditës së Gjykimit në përgjithësi, dhe fakti se njeriu për veprat e tij, në Ditën e Gjykimit do të përgjigjet para Allahut, në veçanti.

6. Dhënia pas dynjallëkut dhe pakujdesia ndaj botës tjetër (ahiretit), është një ndër shkaktarët kryesor të dobësisë së shpirtit, andaj, njeriu vazhdimisht duhet ta përkujtoj ahiretin, Xhenetin, Xhehenemin. Kjo i ngjall zemrat e atyre të cilët e bëjnë këtë duke e dashur shpërblimin të cilin Allahu ua ka premtuar atyre të cilët përpiqen.

7. Edhe përkundër rëndësisë së madhe që ka të përkujtuarit e ahiretit, përqendrimi në këtë institucion të rëndësishëm është lënë anash nga ana e thirrësve. Që gjendja të jetë edhe më e mjerueshme këtë lënie anash e arsyetojnë me kundër efektet nga ana e atyre të cilët i thërrasin në fe. Mirëpo, thirrësi i cili jeton me Kuran dhe Sunet mund të kuptoj që thirrja në fe e thurur me shpërblimin dhe dënimin, dynjallëkun dhe ahiretin, lë gjurmë te njerëzit.

E lusim Allahun e Lartësuar që të na udhëzoj në Rrugën e Drejtë, ndërsa veprat tona të na i harmonizoj me traditën (sunitin) e të Dërguarit të Tij salallahu alejhi ue sellem. Besimi në ekzistimin e Ditës së Gjykimit dhe belave të saj lë shenja në zemrën e besimtarit, ndërsa ato shfaqen me fjalë dhe me gjuhë.

Autor: Abdulaziz b. Nasir el-Xhelil
Përktheu nga gjuha boshnjake: Ebu Eljesa
25.2.2005

Hadithi: Dy fjalët e lehta në gjuhë

Transmetojnë Imam Buhariu dhe Imam Muslimi në sahihet e tyre nga Ebu Hurejra, radijAll-lahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Dy fjalë janë të lehta në gjuhë, të rënda në Mizan (peshorje), të dashura te Mëshiruesi: SubhanAll-lahi ve bihamdihi, subhanAll-lahil-adhiim.”

Dobitë që i përfitojmë nga ky hadith:

1. Koha që e kemi në disponim për të bërë vepra të mira është shumë e shkurtë, mirëpo All-lahu, subhanehu ve teala, nga mëshira e tij e gjerë, na ka bërë lehtësime dhe na ka mundësuar që me vepra të vogla të arrijmë shpërblyme të mëdha. Shembujt për këtë janë të shumtë në fenë e All-lahut, subhanehu ve teala, e ne këtu do ti përmendim vetëm disa:

-Hadithi që cekëm më lart, andaj analizoje mirë atë!

-Shembull tjetër është hadithi ku Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Kush ulet pasi e fal namazin e sabahut (në xhami) dhe e përmend All-lahun deri sa të lindë dielli, pastaj ngrihet dhe i fal dy rekate, është sikurse një haxh dhe një umre e plotë, e plotë, e plotë.”

Pra, paramendo vëlla i dashur, i fal dy rekate e All-lahu të shpërblen sikur të kesh bërë një haxh dhe umre. Mirëpo duhet të kihet parasysh se kjo gjë nuk e shpague obligimin e haxhit.

-Shembull tjetër është ky hadith: Transmeton Buhariu dhe Muslimi se Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Kush thotë 100 herë në ditë “La ilahe il-All-lahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kul-li shejin kadir”, ka shpërblim sikur t’i ketë liruuar 10 robër. Atij i shkruhen 100 të

mira, i fshihen 100 mëkate, dhe është i mbrojtur nga shejtani deri në mbrëmje. Askush nuk ka vepruar më mirë se ky person, përpos atij që e thotë këtë më tepër herë.”

Me të vërtetë shembujt për këtë janë të shumtë, e falënderimi i takon vetëm All-lahut, andaj interesohu më tepër për këtë çështje. (referoju librit “Mburoja e muslimanit”).

2. Në këtë hadith Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, na mëson që mos t’i nënçmojmë veprat e mira, edhe në qoftë se në sytë tonë ato duken të vogla, sepse te All-lahu mund të jenë të mëdha dhe të shpërblyera shumë.

Në lidhje me këtë Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Mos nënçmoni asgjë nga veprat e mira, po qoftë edhe ta takoni vëllain tuaj me buzëqeshje.”

Po ashtu transmeton Imam Muslimi nga Ebu Hurejra, radijAll-lahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Nuk do të hyni në Xhennet derisa të besoni, dhe nuk do të besoni derisa të duheni. A t’ua tregoj një vepër, të cilën nëse e bëni do të duheni? - Jepni selam njëri tjetrit.”

All-lahu ekber! I dërguari i All-lahut e ndër-lidh selamin me dashurinë vëllazërore dhe me hyrjen në xhennet, edhe pse ndoshta kjo neve na duket një gjë e vogël. Andaj, All-lahu të mëshiroftë, analizoje mirë këtë gjë.

3. Ky hadith është një ndër argumentet e shumta që tregojnë se në Ditën e Gjykimit do të vendoset Mizani (peshorja) dhe do të peshohen njerëzit dhe veprat e tyre.

All-lahu subhanehu ve teala thotë: “Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të

drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa pesha e një korrre të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës.” [El-Enbija: 47].

Argument se edhe njerëzit do të peshohen në ditën e gjykimit është hadithi që e transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Me të vërtetë do të vijë burri i madh dhe i shëndoshë, ditën e gjykimit, e nuk do të peshojë te All-llahu as sa një krah mushkonje”, pastaj i dërguari i All-llahut e lexoi ajetin: “Të tillët janë ata që nuk besuan argumentet e Zotit të tyre as takimin (ringjalljen) e Tij, andaj veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e gjykimit atyre nuk do t'u japim kurrfarë vlere.” [El-Kehf: 105].

Sa anë do t'i ketë peshorja? Peshorja do t'i ketë dy anë: atë të veprave të mira dhe atë të veprave të këqija. Argument për këtë është hadithi ku Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tregon se një njeriu do t'i vendosen në peshojë, në njërën anë disa regjistra me vepra të këqija, kurse në anën tjetër një kartë në të cilën shkruan “La ilahe il-All-llah”. [sahih, Imam Ahmedi, Tirmidhiu, Ibën Maxhe etj.] [Shih librin: “Besimi i Mjaf-tueshëm” me komentin e Ibën Uthejmin].

4. Po ashtu në këtë hadith përmendet një cilësi (sifat) prej cilësive të All-llahut, e ajo është cilësia e dashurisë.

Detyra jonë përball të cilave cilësi të All-llahut është që t'i pranojmë ato siç cekem në Kuran dhe sunnet: pa mohim, pa shtrembërim të kuptimit, pa komentim të gabuar dhe pa përngjasim.

Kjo është akideja e ehli sunnetit, e sahabeve dhe pasuesve të tyre, e imamëve të katër medhhebeve, andaj kush e kundërshton këtë

është bidatçi. [Për më gjërësisht “Besimi i Mjaf-tueshëm” me komentin e Ibën Uthejmin].

5. Në këtë hadith si dhe në shumë hadithe tjera, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na nxitë që ta përmendim All-llahun sa më shumë me dhikre që janë cekur në Kuran dhe sunnet (shih “Mburoja e muslimanit), sepse kjo vepër ka vlerë të madhe, All-llahu e do atë dhe e shpërblet shumë.

Dobitë e dhikrit janë të shumta, e në vijim do t'i përmendim disa prej tyre:

-Dhikri e forcon lidhjen mes robit dhe Krijuesit të tij.

-Dhikri është ndër ibadetet më të mëdha, siç ka thënë All-llahu, subhanehu ve teal: “... e përmendja e All-llahut është më e madhja.”(ajet)

-Kjo vepër është shkak për faljen e mëkateve dhe fitimin e sevapeve, e për këtë ekzistojnë hadithe të shumta.

-Kjo vepër rëndon shumë në peshojë.

-Kjo është një vepër që e do All-llahu, e nga kjo kuptohet se e do edhe vepruesin e saj.

-Kjo vepër e largon shejtanin dhe vesveset e tij, si dhe e mbron njeriun nga ai dhe sherri i tij.

-Dhikri e pastron zemrën dhe ia shton devotshmërinë.

-Nëse ti e përmend All-llahun subhanehu ve teal, Ai do të përmend ty.

All-llahu, tebareke ve teal, thotë: “Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. Për ata që All-llahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!” [Ali Imran: 190-191]

Omer Islami,

4.3.2005

Gruaja jote është e gjithë bota për ty

Kur martohesh, nuk merr vetëm grua, por e merr gjithë botën. Prej këtij momenti e tutje, ajo çdo ditë do të jetë partneri yt, shoqëruesi yt dhe shoku yt më i ngushtë.

Ajo do të ndajë momentet me ty, do të ndajë ditët, lotët. Ajo do të ndajë kënaqësinë dhe dëshpërimin me ty, sukseset dhe dështimet, ëndrrat dhe frikët. Kur të sëmurësh ajo do të kujdeset më së miri për ty, kur të duhet ndihmë, ajo do të bëjë çmos për ty.

Kur të kesh ndonjë sekret, ajo do ta ruajë; kur të duhet këshillë, ajo do ta jep këshillën më të mirë. Ajo çdoherë do të jetë me ty: kur të ngrihesh në mëngjes, gjënë e parë që sytë e shohin është ajo; gjatë ditës ajo do të jetë me ty, nëse për ndonjë moment ajo nuk është me ty fizikisht, ajo do të mendojë për ty, duke u lutur për ty me gjithë zemër, mendje dhe shpirt; kur bie të flesh natën, gjënë e fundit që sytë e tu e shohin është ajo; dhe kur je duke fjetur e shef atë edhe në ëndërr. Thënë shkurt, ajo do të jetë e gjithë bota për ty, njëjtë siç je ti e gjithë bota për të.

Përshkrimin më të mirë që deri tani e kam lexuar ku përshkruhet afërsia ndërmjet bashkëshortëve është ky ajet Kur'anor, që thotë: "...ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato..." (El-Bekare: 187)

Vërtetë, bashkëshortët janë si prehje (mbulesë/mbulim) për njëri-tjetrin për shkak se ata njëri-tjetrit i ofrojnë mbrojtje, komfor, mbulesë, përkrahje dhe ëmbëlsi që prehja/mbulimi ua ofron njerëzve. Paramendoni një udhëtim nëpër Alaskën e ftoftë të pa mbuluar! Bashkëshortet tona na ofro-

jnë të njëjtën shkallë të komfortit, mbrojtjes, mbulesës, dhe përkrahjes në udhëtimin e jetës në këtë botë, njëjtë sikurse mbulimi gjatë udhëtimit nëpër Alaskë.

Marrëdhëniet ndërmjet dy bashkëshortëve janë më interesantet nga të gjitha marrëdhëniet njerëzore: sasia e dashurisë dhe ngrohtësisë, intimitja dhe afërsia, mëshira dhe ngushëllimi, paqja dhe qetësia që mbush zemrat e bashkëshortëve është thjesht e papërshkrueshme. Sqarimi i vetëm racional për këto ndjenja më interesante nga të gjitha ndjenjat njerëzore është se: ky është një akt i Allahut, subhanehu ve te'ala: "All-llahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj..." (Nahl: 72)

Vetëm Allahu i Gjithëfuqishëm me Fuqinë e tij të Pakufishme, Mëshirën e Pafund, dhe Mençurinë e Madhe mund t'i krijojë dhe t'i vendosë këto ndjenja të çuditshme dhe të paprekshme në zemrat e bashkëshortëve. Allahu, subhanehu ve te'ala, i rikujton ata që i kërkojnë shenjat e Tij në gjithësi, se këto ndjenja në zemrat e bashkëshortëve janë ndërmjet shenjave që duhet t'i udhëzojnë njerëzit për ekzistimin e Tij, siç thotë në Kur'an: "Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë" (Rum: 21)

Mirëpo, Allahu, subhanehu ve te'ala, e din se zemra njeriut nuk është një send i ngurtë, ajo ndonjëherë është e dobët, e ndonjëherë është dinamike. Ndjenjat ndryshojnë me

kohë. Dashuria mund të dobësohet dhe vyshket. Lidhja martesore mund të dobësohet nëse nuk i kushtohet kujdesi i duhur.

Lumturia në martesë nuk mund duhet të merret falas; lumturia e vazhdueshme kërkon dhënie të vazhdueshme nga të dyja palët. Që druri i dashurisë martesore të mbahet gjallë dhe të rritet, toka, dheu duhet të mbahet, mirëmbahet, ujitet dhe t'i kushtohet kujdes.

Mos harro se i Dërguari jonë, Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka gjetur kohë të shkojë në shkretëtirë dhe të garojë më bashkëshorten e tij, Aishen. Ajo në fillim e ka fituar atë, mirëpo më vonë, pasi kishte shtuar pak në peshë, ai kishte filluar ta fitojë atë.

Mos harro se do të shpërblehesh nga Allahu, subhanehu ve te'ala, për çfarëdo emocioni që ia tregon bashkëshortes tënde. Për këtë Muhamedi, sal-lalhu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "...madje edhe ushqimin që e vendos në gojën e gruas së tënde është sadaka..".

Asnjëherë mos e nënçmo rëndësinë e gjërave që, në shikim, duken të vogla, siç është vendosja e ushqimit në gojën e bashkëshortes, hapja e derës së veturës, etj. Mos harro se Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, zakonisht ka zgjatur gjunin për t'i ndihmuar gruas së tij të hipë në deve.

Përpiqu të gjesh kohë që të dy të faleni së bashku. Përforcimi i lidhjes ndërmjet juve dhe Allahut, subhanehu ve te'ala, është garancia më e mirë se lidhja juaj martesore çdoherë do të jetë e fortë. Paqja dhe rahatia me Allahun, subhanehu ve te'ala, çdoherë do të rezultojë me paqe dhe rahat në shtëpi.

Mos harro se Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka lavdëruar çiftet bashkëshortore që janë zgjuar për të falur namaz nate së bashku. Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, madje edhe ka nxitur atë që

zgjohet më herët të zgjojë bashkëshortin/bashkëshorten edhe nëse është e nevojshme, duke ia lagur fytyrën me ujë.

Çdoherë mundohu të jesh sa më i mirë me gruan në fjalë dhe në vepra. Fol me të, buzëqeshi, kërko këshillën e saj, kërko mendimin e saj, kalo kohë të mirë me të dhe mos harro se Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "më të mirët prej jush janë ata që janë më të mirë me gratë e tyre".

Dhe më në fund, është e zakonshme që bashkëshortët pohojnë se i duan dhe i nderojnë bashkëshortët e tyre deri në vdekje. Besoj se ky pohim është i mirë, madje i shkëlqyeshëm, mirëpo nuk mjafton vetëm kjo! Nuk mjafton vetëm ta duash gruan. Duhet të duash atë që ajo e do. Familjen e saj, të afërmit e saj duhet të bëhen edhe të afërmit e tu. Mos u bë si një mik i imi i cili ishte dëshpëruar se prindërit e bashkëshortes do t'i vinin mysafirë për disa javë. Ai drejt dhe thjesht i kishte thënë bashkëshortes "Nuk i dua prindërit e tu". Natyrisht, ajo me mllef e ka shikuar drejt në sy dhe i ka thënë "As unë nuk i dua prindërit e tu"...

Po ashtu, nuk mjafton ta duash atë deri në vdekje. Dashuria nuk duhet të përfundojë asnjëherë dhe ne besojmë se ka jetë pas vdekjes ku ata që kanë bërë vepra të mira në këtë botë do të bashkohen me bashkëshortët (Al-Zuhruf: 70)...

Shembulli më i mirë në këtë kuptim është Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dashuria e të cilit për Hatixhen, bashkëshorten e tij për 25 vjet është zgjeruar dhe ka përfshirë të gjithë ata që ajo i ka dashur, dhe ka vazhduar edhe pas vdekjes së saj. Kishin kaluar shumë vjet nga vdekja e saj dhe ai asnjëherë nuk e harroi atë, dhe çdoherë që priteshe ndonjë kurban në shtëpinë e tij, ai do të dërgonte një pjesë familjes së Hatixhes, radijallahu anha...

Përktheu: xh.a.

11.2.2005

Këshilla të vogla për një kurim të madh

Motrave muslimane me dashuri e respekt... (l.k.)

Merr rrënjët e përlësisë me gjethet e durimit dhe farat e modestisë e të devotshmërisë. Shto lulet e pendimit dhe të bindjes. Tërë këtë hidhe në një enë të virtytit. Ndiz zjarrin e dashurisë së Allahut duke i zbatuar praktikat me çka jemi urdhëruar (porositur) deri në shfaqjen e urtësisë. Derdhe këtë çaj të urtësisë në një gotë të sinqeritetit. Ëmbëlsoje të tërën me mjaltin e takimit me Allahun në ditën e Ringjalljes, dhe ti do të vësh se ky çaj do t'i largojë të gjitha sëmundjet që ndodhen mbi tokë». E dashura motër ! Për të gjitha rastet dhe në çdo kohë, që bukuria jote të jetë sa më e madhe:

Vë penelatën e sinqeritetit në buzët tua, ato do të jenë pafundësisht më të bukura:

Përdore pendimin si pastrues të çdo mëkati, që kishe për t'u ankuar.

Mbroj flokët tua me mbulesën që do të mbronte nga shikimet e zjarrta e të huajve.

Të gjitha këto pajisje të mrekullueshme ti do të mund t'i gjeshe vetëm në «dyqanin» e Islamit, përfito pra nga ky rast dhe nxito t'i fitosh!

Për buzë tërheqëse, përdor fjalët më të buta.

Për sy të bukur, kërko të mirën në rrethin tuaj.

Për një fytyrë të përhjekur, ndaje ushqimin tënd me të varfrin.

Për flokë të mëndafshtë, lere fëmijën që t'i përshkojë ato me gishtërinjtë e vet një ose dy herë në ditë.

Për drejtpeshim, ecni me bindjen se nuk ecni kurrë vetëm.

Familja dhe miqtë duhet të trajtohen me kujdesin më të madh dhe me shumë dashuri; Kurrë mos përzini jashtë këdo qoftë.

Kujtohuni, nëse kini nevojë për një dorë ndihmëse, ju do ta gjeni atë në anën e skajshme të krahut tuaj. Gjatë plakjes, do të hetoni se ju kini dy duar, një për t'u ndihmuar, tjetër për t'i ndihmuar të tjerët.

Bukuria e një femre nuk qëndron në veshjen që mban ajo, as në dukjen fizike të saj e as në mënyrën e të krehurit të flokëve. Bukuria e një femre duhet të shihet në sytë e saj, sepse, ajo është derë e zemrës, vendqëndrimi dashurisë.

Bukuria e njëmendtë e një femre pasqyrohet përmes shpirtit saj. Kjo është ngrohtësia që e jep me dashuri, pasioni që e tregon.

Zgjedhi e përktheu:

L.Kullashi

18.2.2005

“...dhe mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre...”

Ka kaluar shumë kohë prej atëherë që kur gratë të flitnin rreth problemeve të tyre martesore, të flitnin me fjalë të buta dhe në një mënyrë të kufizuar. Sot, megjithatë, zërat e tyre janë trashur. Ankime dhe murmurime dëgjohen shumë më shpesh, për shumë situata shokuese, të shëmtuara dhe që shkatërrojnë zemrat. Kjo bën që më shumë gra të bashkohen duke pyetur një pyetje të vjetër që është e bërë e pavdekshme në vargjet poetike:

Ti më hodhe tutje dhe çfarë njeriu ti humbe?

Kush ishte atje për ty
kur kohërat ishin të vështira
dhe kur t'i duheshe të luftoje

Shumë pasoja tragjike kanë rezultuar nëpër martesa thjeshtë nga paaftësia e burrave për të kuptuar natyrën e grave dhe çfarë ato kalojnë përmes stresit psikologjik dhe emocional për shkak të ndryshimit të hormoneve që u ndodh gjatë periudhave të tyre mujore ose gjatë shtatzënisë dhe lindjes. Ka shumë gjasa që mu kjo është ajo të cilës pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sellem, i është referuar kur tha: “...Gruaja është një brinjë. Nëse përpiqesh ta drejtosh atë, ti do ta thyesh dhe nëse e lë sikurse është, ti duhesh të gëzohesh me shtatin e saj”. [Sahih el-Buhari 5184]

Në një hadith tjetër, thuhet: “Nëse ti përpiqesh ta drejtosh, ti do ta thyesh dhe thyerja e saj nënkuptonin divorcin (ndarjen) prej saj”. [Sahih Muslim 1468]

Allahu ka thënë qartë: “...dhe mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre, e edhe ato

të mos dalin ndryshe vetëm nëse bëjnë ndonjë vepër të keqe të vërtetuar. Këto janë dispozitat e All-llahut, e kush del jashtë dispozitave të All-llahut, ai e ka dëmtuar vetveten. Ti nuk e di, All-llahu pas asaj mund të të japë diçka rishtazi”. (Talak :1]

El-Kurtubi komenton këtë ajet duke thënë [Tefsir el-Kurtubi 18/102]:

“Nuk është e drejtë që burri të nxjerrë atë (gruan) jashtë shtëpisë gjatë periudhës së saj në pritje. Gjithashtu nuk është e lejuar për atë që të largohet me vullnetin e saj përderisa nuk ka një shkak të qartë për të që të veprojë kështu. Nëse ajo del jashtë, ajo është gjynahqare. Periudha e saj në pritje nuk përfundon (vetëm me largimin jashtë shtëpisë). Nuk ndryshon kjo dispozitë nëse burri ka një zgjedhje për të tërhequr divorcin (vlen në të dyja rastet, edhe kur ka ende zgjidhje e edhe kur ka mbaruar sh.r.)”.

Nëse ky është gjykimi mbi divorcin, sa i rënduar është rasti për ta përzënë gruan nga shtëpia vetëm për shkak të një mos rënie dakord?

Ku do të gjejë ajo paqe?

Ku është këtu dashuria dhe mëshira që janë të supozuara të jenë pjesë e martesës?

Të shumtë janë burrat që refuzojnë çdo gjë pos t'i drejtojnë gratë e tyre, jo vetëm me fjalë por edhe duke shkatërruar çdo gjë, përfshirë edhe marrëdhëniet familjare. Në këtë mënyrë, njeriu madje nuk arrin ta mbyll defterin e martesës së tij në një mënyrë miqësore dhe civile. Në vend të kësaj, ai e shqyen, duke i hedhur faqet e tij të çmuara

në erë, duke e detyruar gruan e tij të largohet për në një shtëpi tjetër e fëmijët në tjetër. Mizoria e një burri të tillë është jashtë-njerëzore.

Pse disa burra insistojnë sa herë që ka ndonjë mosmarrëveshje t'i nisin gratë e tyre bashkë me plaçkat që i kanë, duke i detyruar të shkojnë ata tek familjet e tyre? E gjithë ajo që ai fiton me këtë në këtë rast është zvogëlimi i shanseve për ribashkim. Dhe shkatërron me këtë jetët e fëmijëve të tij dhe të gjitha këto pa asnjë qëllim.

Ne mund të marrim një mësim nga historia e famshme e Aishe el-Hath'emije dhe burrit të saj Hasan bin Ali, radijallahu anhu. (djali i Aliut, radijallahu anhu sh.r.)

Kur babai i tij vdiq dhe Hasanit ju dha betimi si Halife, ajo i tha atij: "Ti je për përsëritje, sepse je bërë Halife".

Ai ju përgjigj: "Aliu është vrarë dhe ti po shfaq një gëzim dashakeqës! Largohu! Ti je e divorcuar (e ndarë), tri herë".

Ajo hoqi rrobën e saj dhe priti periudhën e pritjes. Pastaj Hasani i dërgoi asaj 10.000 monedha ari si kompensim, gjithashtu ai i dha asaj pjesën që mbetej nga mehri i saj.

Kurse ajo tha: "Kjo është një kompensim i vogël për largimin tim nga dashuria ime".

Kur ai e dëgjoi çfarë ajo kishte thënë, ai qau dhe tha: "Sikurse të mos ta kisha bërë divorcin të parevokueshëm. Unë do ta kisha

marrë prapë atë".

Ne mund të shohim në shembullin e mirë të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, - Pejgamber i mëshirës - që kur ai përballej me kriza familjare në madhësi të mëdha, si atëherë kur për gruan e tij Aishen, radijallahu anha, ishte shpifur. E ajo ishte nga njerëzit më të dashur të tij dhe ishte tepër sprovuese për të që njerëzit të bënin të tilla akuza rreth saj. Përkundër kësaj, gjatë tërë ngjarjes ai kurrë nuk u konfrontua me të rreth këtij incidenti e as që tregoi asnjë shenjë të vrazhdë ndaj saj. Megjithëse pëshpëritjet vazhduan për një muaj, ai kurrë nuk e lejoi shqetësimin të bëhej i dukshëm në sytë e saj. Ido ditë, ai do të sigurohej që ajo ishte mirë, sepse ajo ishte e sëmurë me ethe, përkundër barrës së madhe që ai ishte duke mbajtur mbi supe.

Aisheja, radijallahu anha, transmeton të mëposhtmen rreth atyre kohërave: "Unë isha e sëmurë për një muaj. Kur unë u ktheva dhe njerëzit ishin duke pëshpëritur shpifjet. Unë nuk dija aspak se çfarë ata ishin duke thënë për mua por unë e ndieja që butësia e të dërguarit të Allahut, me të cilën isha mësuar kur unë isha e sëmurë nuk ishte aty. Ai vetëm më pyeste sesi ndjehesha dhe pastaj dilte". [Sahih el-Buhari 4750]

Fevzije el-Hulejvi
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
4.3.2005

Imam Es Sefarini

Imam Muhammed ibën Ahmed Es Sefarini. Shejhu, Imami, Deti i dijës, Al-lameja, dijeta-ri që punonte me dijen e tij, autori i veprave të dobishme Ebul Aun, Shemsuddin, Muhammed ibën Ahmed ibën Salim ibën Sulej-man Es Sefarini En Nablusi...

Ka lindur në fshatin Sefarin në afërsi të Nablusit në vitin 1114 H dhe në atë fshat e kaloi fëmijërinë. Mësoi Kur'anin dhe pastaj udhëtoi në Damask në kërkim të dijës së dobishme. Mësuesit e tij në këtë qytet të Shamit ishin:

-Esh Shejh Abdul Ganij ibën Isma'il En Nablusi

-Shejhul Islam Muhammed ibën Abdur Rahman El Gazzij

-Shejh Ebul Ferexh Abdur Rahman ibën Muhjuddin El Muxhel-led

-Shejh Ebu El Mexhd Mustafa ibën Mustafa Es Suvari

-Shejh Abdul Kadir ibën Umer Et Teglubij

-Shejh Ebul Fedail El Keuri dhe tjerë.

Për kohë të shkurtë tuboi dije të madhe dhe u bë i njohur me dijen e tij si dhe me mençurinë e urtësinë me të cilën e dalloi All-llahu, subhanehu ve teala. Filloi me ligjë-rata dhe mësimdhënien dhe për një kohë të shkurtër u bë i njohur me veprat e tij të shkruara. Nga veprat e tij do të përmendim:

-Sherhu thulathijat Imam Ahmed

-Sherhu Nunijjetis Sarsuri (Me'arixhul En-var fi Sireti En Nebijj El Muhtar)

-Tebhirul Vefa fi Siretil Mustafa

-Gidhaul Elbab fi sherhi mendhumetil Adab

-El Buhur Ez Zahire fi 'Ulumil Ahire

-Keshful Litham fi Sherhi 'Umdetil Ahkam

-Netaixhul Efkar fi Sherhi Hadithi Sejjidil Istigfar

-El Xhavab El Muharrer fi keshfi an Hidr vel Iskender etj.

Gjatë jetës së tij shkroi mbi njëzet e pesë libra. Ishte i njohur edhe me poezitë e tij të bukura si dhe me vazet që zgjonin ndjenja të larta tek dëgjuesit.

Bashkëkohorët e tij kështu e përshkruanin atë: I Dalluari i kohës, pas tij nuk është paraqitur dijetar si ai, i drejti me kuptim të thellë të gjërave. I fuqishmi në refuzimin e padrejtësisë dhe shpifjeve. Kur shihte ndonjë të keqe skuqej dhe zëri i tij tregonte pakënaqësinë dhe hidhërimin e tij me atë vepër. Ishte i butë dhe bashkëbisedues i këndshëm, e njëjtte mirë historinë e mbretërve, dijetarëve dhe luftërat gjatë historisë. Vdiq në muajin e Shevalit të vitit 1188 H. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjerë. Amin.

Talha Kurtishi,

11.2.2005

Ibën Ahmed el Hakemi

Esh shejh, hafidh, ibën Ahmed el Hakemi. Dijetari i madh, Al-lameja i Xhazanit dhe i gadishullit arabik, autori i librave të dobishme në shumë lëmi, luani i Tihames (krahinë në Arabinë Saudite), thirrësi që së bashku me mësuesin e tij arritën të përhapin dijen e dobishme dhe fenë e pastër në disa vende, në të cilat mbretëronin injoranca dhe risitë.

Quket Hafidh ibën Ahmed ibën Ali El Hakemi El Kahtani. Lindi në vitin 1343 H (1924 G) në fshatin Es Selam në afërsi të qytetit Medaja në juglindje të Xhazanit (Arabia Saudite). Akoma si foshnjë së bashku me familjen e tij shpërngulen në fshatin Xhadi' në afërsi të qytetit Samita. Familja e tij e varfër dhe modeste arriti që në personalitetin e Hafidhit të mbjellë dashurinë për hajrin, ndershmërinë, bujarinë, modestinë dhe shumë cilësi të mira. Zgjuarsia e tij, shpejtësia në mësimin e gjërave dhe kuptueshmëria e tij e bën atë të dalluar prej fëmijëve të fshatit. Si i vogël mësoi shkrimlexim dhe Kur'an. Akoma pa i mbushur dymbëdhjetë vjet mësoi përmendsh të shumtën e Kur'anit. Se bashku me vëllain e tij Muhammedin kalonte kohën në shkrimin e Kur'anin me shkrim dore, në leximin e librave të fikhut, hadithit, tefsirit, teuhidit dhe feraidit. Aftësia e madhe për mësim përmendësh i ndihmoi që shumë prej këtyre librave t'i mëson përmendsh.

Në fillim të vitit 1358 H krahinën e Tihames e vizitoi dijetari i njohur Abdullah El Kar'avi i cili pasi që prej së afërmi u njoftua me injorancën dhe risitë që ishin shumë të

përhapura vendosi të përqendrohet në atë krahinë duke përhapur besimin e pastër dhe sunetet e të Dërguarit të cilat aty më, ishin zëvendësuar me risi (bidate).

Kur Hafidhit të ri i erdhi lajmi për këtë dijetar, ai së bashku me vëllain e tij i dërguan një letër duke kërkuar fillimisht falje për mosprezencën e tyre në ligjëratat e dijetarit për shkak të angazhimeve në shërbim të prindërve si dhe kërkuan prej tij t'u dërgon disa libra ose të viziton fshatin e tyre.

Pasi që morri letrën e tyre El Kar'aviu vendosi të viziton fshatin e tyre për të ligjësuar në të. Më i dalluari në shkrim dhe mësim në ligjëratat e tij ishte El Hakemi, i cili shumë shpejt shkruante dhe mësonte përmendësh atë që e ligjëronte hoxha. Shpesh nxënësit tjerë kërkonin prej tij që t'ua shpjegon mësimet si dhe që të shkruajnë atë që nuk arritën ta shkruajnë gjatë ligjëratave.

Dijetari vërejti këtë zgjuarsia dhe kërkoi prej prindërve t El Hakemiut të lejojnë që ai (Hafidhi) të vazhdon kërkim e dijës në qytetin e Samita-së duke marrë përsipër pagën e shërbëtorit që do të zëvendëson El Hakemiun në punën e tij si bari. Ata nuk e lejuan këtë gjë duke e potencuar nevojën e tyre për prezencën e tij në shtëpi.

Pas vdekjes së nënës në vitin 1360 H, prindi i tij i lejoi atij dhe vëllait të tij shkojnë në qytet tre ditë në javë. Gjatë ditëve të mësimet i shkruante mësimet dhe pastaj kthehej në fshat duke vazhduar punët e rëndomta fshatare. Gjatë kthimit prej Haxh-xhit baba i El Hakemi-ut ndërron jetë dhe El

Hakemiu tërësisht i përkushtohet dijës në praninë e mësuesit të tij prej të cilit përfitoi shumë dije.

Mësuesi i tij kujdesej që t'i siguron gjithë librat bazë, që në atë kohë ishin të rralla, për nxënësin e tij të talentuar. Gjatë kërkimit të dijës ai lexoi librat bazë në gjitha lëmit e fesë.

Pasi që i mbushi nëntëmbëdhjetë vjet mësuesi i tij kërkoi prej tij përpilimin e një libri që do të paraqet besimin islam në formë të poezisë. Duke iu përgjigjur kërkesës nga mësuesi shkroi librin "Sulemul Vusul ila ilmil Usul".

Këtë libër më vonë e komentoi në librin e tij të njohur "Me'arixhul Kabul"

Përpos këto dy libra nga penda e tij u shkruan edhe këto libra:

- A'lam Es Sunne El Menshure (në lëmin e akidës) e përkthyer shqip me titull: 222 pyetje dhe përgjigje rreth akides

- El Xheuhere el Feride fi tahkik El Akide (në formë të poezisë)

- Delilu Erbabil Felah li tahkik fenil lstilah (terminologjia e hadithit)

- Lu'lu'ul Meknun (mbi terminologjinë, në formë të poezisë)

- Es Subul Es Sevijje li fikhi Es Sunen El Mervijje (fikhi, në formë të poezisë)

- Vesiletul Husul ila Muhimmatil Usul dhe Lamijetul Mensuh (usulul fikhi, në formë të poezisë)

- En Nur El faid min Shemsil Vahj fi Ilmil Feraid (ilmul feraid, e drejta trashëgimore)

- Nushul Ihvan (El Katije) si dhe Mendhumentum Mimije (Këshilla të dobishme në formë të poezisë)

- Nejlu Suul min Tarihil Umem ve Siretir Resul (Biografi e të Dërguarit, sal-lall-llahu

alejhi ve sel-lem, në formë të poezisë)

Përpos veprimtarisë së shkruar ai ishte dora e djalhtë e mësuesit të tij i cili mbikëqyrte shkollat që vet i hapi në krahinat Ti-hame dhe Asir. Ai i ndihmonte në çështjet e mësimit si dhe në udhëheqjen me këto shkolla.

Kur në vitin 1373 H u hap shkolla e mesme e parë në qytetin e Xhazanit drejtor i saj u emërua Shejh El Hakemiu i cili më vonë punoi edhe si dekan dhe profesor në degën e Fakultetit të Sheri'atit të Universitetit Imam Muhammed ibën Su'ud, i cili u hap në vitin 1374 H.

Ata që jetuan më të kështu e përshkruanin: Ishte shembull i dijetarit që kërkonte dije të dobishme në baza të shëndosha shkencore...

Ishte bujar, i devotshëm dhe i përmbajtur ndaj gjërave të dyshimta. Me besim të fortë e ngriste lart zërin e të vërtetës, urdhëronte për të mirë dhe vet e bënte, ndalonte nga e keqja dhe vet i pari u largonte...

Tubimet e tij ishin plot dobi, ishte i rrethuar me nxënës në çdo vend, në shtëpi, në shkollë, në xhami...Kohën e kalonte duke lexuar Kur'an dhe libra të dobishme...Njeriu ndihej mirë në praninë e tij shpeshherë bënte shaka me shokët e tij duke mos i kaluar kufijtë.

Pasi që bëri Haxhxin në vitin 1377 H (1958 G) duke qenë akoma në Mekke, ndërroi jetë ky dijetar i madh. Vdekja e tij në moshën e re ishte goditje e madhe për muslimanët. Mbetën vetëm librat e tij që dëshmojnë dhe do të dëshmojnë për këtë pishtar ndriçues që udhëzonte me dijen e tij. All-llahu e mëshiroftë më mëshirën e Tij të gjërë.

Talha Kurtishi,
18.2.2005

Imam Esh Shatibi

Ebu Is'hak, Ibrahim ibën Musa ibën Muhammed El Garnati i njohur si Esh Shatibi me të drejtë konsiderohet një prej imamëve të dalluar të Islamit.

Ka lindur në qytetit Shatibe të Andaluzisë, Spanjë, që në atë kohë ishte pjesë e shtetit Islam. Për vitin e lindjes historianët nuk japin ndonjë informatë të prerë.

Gjatë kërkimit të dijes ka përfituar prej dijetarëve të njohur të asaj kohe siç janë:

Ebu Abdil-lah Muhammed ibën Feh-har El Bejri

Ebu Xha'fer Ahmed Esh Shekuri

Ebu Se'id Ferexh ibën Kasim Et Teghlubi

Ebu Abdil-lah Muhammed ibën Ali El Belensi

Ebu Abdil-lah Muhammed ibën Ebil Haxh-xhaxh El Jahsubi dhe shumë tjerë.

Ishte i dalluar në shkencën e bazave të fikhut, në shkencën e hadithit dhe atë të fikhut. Me studimin e tij të palodhshëm u bë i njohur dhe u rreshtua në mesin e prijësve të njohur të fesë.

Nga ky det i dijes përfituan shumë dijeta-

rë të njohur të Andaluzisë prej të cilëve do t'i përmendim:

Vëllau i tij El Kadi Ebu Bekr Esh Shatibi

Ebu Jahja Muhammed ibën Asim

Muhammed El Bejani

Ebu Xha'fer Ahmed El Kas-sar

Ebu Abdil-lah Muhammed ibën Muhammed El Mexhari etj.

Me penën e tij shkroi libra të dobishme në të cilat u mundua t'i përpunon rregullat e përgjithshme të fesë duke shënuar edhe shumë dobi të rëndësishme:

“El l'tisam”

“El Ifadat vel Inshadat”

“Sherhun Xhelil ala El Hulasati fin Nahv”

“Unvanul It-tifak fi ilmil Ishtikak”

“El Fetava”

“El Muvafekat”

“Kitabul Mexhalis” në të cilin komentoj kaptinën e shitblerjeve (kitanul buju) të Sahih Muslim-it.

Vdiq në muajin Sha'ban të vitit 790 H. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjerë. Amin

Selim El Hilali
Përktheu: Talha Kurtishi
25.2.2005

Imam Ed Darekutni

Njëri prej imamëve me dije enciklopedike, ekspert në shkencat e hadithit, në fikh dhe letërsi dhe me njohuri të gjëra për mënyrat e leximit të Kur'anit. Intelekti i jashtëzakonshëm si dhe kujtesa e fortë e dallonin prej dijetarëve të kohës së tij. Më së shumti ka shkruar në lëmin e hadithit. Vepra e tij "Es Sunen" përmban afro pesë mijë hadithe.

Quhet Ali ibën Umer ibën Mehdi ibën Mes'ud, Ebul Hasen Ed Darekutni El Bagdadi.

Ka lindur në lagjen e njohur e qytetit të Bagdadit, Darul Kutni në vitin 306 H.

Kërkimin e dijës e filloi herët duke vazhduar traditën e dijetarëve të asaj kohe që udhëtonin në kërkim të dijës. Vizitoi qendrat e dijës në atë kohë, siç ishin Basra, Kufe, Vasit, Egjipt, Sham duke përfitur prej shumë mësues nga të cilët do t'i veçojmë: Imam Begaviun, Imam Jahja ibën Muhammed ibën Se'id El Hadramiun, Muhammed ibën Kasim El Muharibiun, Ismail ibën Abbas El Ver-rakun, Xha'fer ibën Muhammed Es Sajdeliun, Ahmed ibën Muhammed El Vasitiun, Ebu Bekr ibën Ebu Davdu Es Sixhistaniun etj.

Fjalët e dijetarëve për Darekutniun:

Ka qenë i respektuar nga dijetarët e kohës së tij si dhe nga kronikët e dijës pas vdekjes së tij.

Hatib El Bagdadi njëri prej autoriteteve në shkencat e islamit Ed Darekutniun e konsideron imam të kohës së tij duke thënë: Ai arriti kulmin e dijës mbi hadithet, njëhte mirë mangësitë e fshehura të disa haditheve si dhe transmetuesit e haditheve.

Imam Hakimi i cili dëgjoi lavdërimet e Ebi

Dhuhlit për Ed Darekutniun i konsideroi të tepruara që më vonë të përgënjeshtrohen veten pasi që dëgjoi një nga ligjëratat e Ed Darekutniut në Bagdad. Ligjëratat e Ed Darekutniut e mahniti atë aq shumë sa që vendosi të mbetej në Bagdad për katër muaj.

Imam Dhehebiu thoshte: Ka qenë det i djesh, njëri prej imamëve të dynjasë.

Ebu Tajjib Et Taberi thotë: Isha i pranishëm kur para tij u cituan disa hadithe që ai i kishte përmbledhur. Edhe Imam Ahmedi do të mësonte diç të re po të ishte i pranishëm.

Ibën El Xhevzi thotë: Si pak njerëz Ed Darekutniun arriti të bashkon dijen e gjerë në hadith, fikh, gramatikë, poezi dhe kiraete me besnikërinë, drejtësinë dhe besimin e pastër.

Ebu Bekr El Berkani thotë: Mangësitë e haditheve i citonte nga kujtesa duke mos përdorur libër.

Ebu Abdur Rahman Es Sulemi thoshte: Askush nën kupën e qiejve nuk i njëjtë mirë të Dërguarin, as'habët, tabi'inët dhe etba'i tabi'inët sesa Imam Ed Darekutni.

El Hal-lali thotë: Dijetarët e hadithit i jepnin përparësi Ed Darekutniut që t'ua falë namazin edhe pse nuk ishte më i vjetri në mesin e tyre.

Është pyetur Imam Sa'd ibën Ali Ez Zenxhani: Kush është hafidh (hafëz) me i fortë në lëmin e hadithit prej këtyre imamëve: Darekutniun në Bagdad, Abdul Ganiij-u në Egjipt, Ibën Mende në Isfahan ose Hakimi në Nisabur? I pyeturi u përgjigj: Ed

Darekutniu më së miri i njej mangësitë e fshehura e hadithit, Abdul Ganiij-u prejardhjen e transmetuesve, Ibën Mende hadithin në përgjithësi kurse Hakimi dallon me mënyrën e bukur të shkrimit dhe shënimit.

Ebu Tajjib Tahir ibën Abdull-llah Et Taberi e quajti: Emirul Mu'minin (Prijësi i besimtarëve, gradë shkencore në shkencat e hadithit sh.r.) në hadith.

Është parë në ëndërr duke u quajtur me titullin Imam (prijës) edhe në xhennet.

Nga ky det i dijes përfituan shumë nxënës nga mesi i të cilëve shkurtimisht do të përmendim:

Imam Ebu Abdil-lah El Hakim En Nejsaburi

Imam Ebu Nu'ajm El Asbehani (autori i librit Hiljetul Evlija)

Imam Ebu Hamid El Isfiraini

Imam Ebu Abdur Rahman Es Sulemi

Imam Ebu Dherr El Herevi etj.

Veprat e tij:

Gjatë jetës së tij i shkroi këto libra që kanë të bëjnë kryesisht me lëmin e hadithit:

- Suneni i cili përmban 4754 hadithe që kanë të bëjnë gjegjësisht me dispozitat e jurisprudencës (fikhut) Islam

- Kitabus Sifat që trajton hadithet që kanë të bëjnë me cilësitë e All-llahut, sub-hanehu ve teala.

- Ehadithun Nuzul

- Musned Ebi Hanife

- Kitabud Du'afai vel Metrukin

- Illelul Hadith

- Garibul Hadith

- El Ilzamat ala Sahih El Buhari ve Muslim

- El fevaid El Efrad

- El Mu'telif vel Muhtelif

- Kitabul Ihve vel Uhuve

- Fadaili Sahabe

- Kitabut Tetebu'i

- El Erbe'une

- El Ehadith el-leti halefe fiha Imam Malik

- itabul Es'hija etj.

Vdiq në vitin 385 H në Bagdad. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjerë.
Amin

Përgatiti: Talha Kurtishi,
4.3.2005i

Pyetje dhe përgjigje

Tema: Fëmija i adoptuar

Numri: 1189 Data: 08.03.2005

Pyetje: ...nëse nëna dhe baba adaptojnë një fëmijë a duhet që kur te rritet ti tregojnë fëmijës se nuk je i yni? dhe a lejohet që ti thuhet- djali im?

Përgjigje: Ve alejkumusselam ve rahmetull-llahi ve berekatuhu. All-llahun e falënderojmë kurse paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, familjen dhe shokët e tij.

Po, nëse dy bashkëshortë e adoptojnë ndonjë fëmijë, duhet ti tregojnë se nuk është i tyri, por është i marrë, sepse nuk është gjaku dhe soji i tyre, por është i marrë për ti ndihmuar dhe për tu kujdesur për te...Mund ti thuhet djali im, sa për përkëdhelje, e jo me kuptimin se është djalë i yti...

All-llahu e di më së miri. All-llahu ju dhëntë dije të dobishme, vepra të mira, besim të shëndoshë, sukses dhe lumturi në jetë.

Bekir Halimi
Redaktor fetar
Albislam.Com
albislam@albislam.com

Pozita e sunnetit në Islam (1)

Falënderimi i takon All-llahu, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, familjen dhe ata që e miqësojnë.

Kjo është një ligjëratë, të cilën e kam mbajtur në Doha, kryeqytetin e Katarit në muajin e bekuar të Ramazanit, të vitit 1392 sipas hixhretit. Disa vëllezër më propozuan që ta botoj, pasi që në te ka dobi të rëndësishme dhe për shkak se muslimanët kanë nevojë për një gjë të tillë. Duke iu përgjigjur kërkesës së tyre e publikoj për ta gjeneralizuar dobinë dhe duke pasur parasysh përmendjen dhe historinë. Ia kemi shtuar disa tituj detal, për ti ndihmuar lexuesit të nderuar që të koncentrohet në pikat kryesore të tij. Shpresoj prej Zotit që të më shkruan në mesin e mbrojtësve të fesë së Tij, përkrahësve të ligjit të Vet, të më shpërblejë për këtë vepër, pasi që Ai është më Bujari prej të cilit kërkohet.

Pozita e sunnetit në Islam dhe sqarimi se nuk mund të mos kemi nevojë për sunnetin, duke u mjaftuar me Kur'an

Mendoj se nuk do të kem mundësi që tu ofroj të pranishmëve, diçka që nuk e kanë ditur më herët, sidomos pasi që në mesin e tyre ka edhe dijetarë dhe profesor të nderuar. Nëse mendimi im është i saktë, më

mjaftuan mua se me këtë fjalim jam përkujtues, duke e pasuar fjalën e All-llahut, tebareke ve teala: "Vazhdo me këshillë, sepse këshilla besimtarëve u bën dobi". (Edh-Dharijat: 55).

Fjalimi im në këtë natë të bekuar prej netëve të Ramazanit nuk mendoj të jetë diçka mbi vlerën e këtij muajit, dispozitive ose vlerës së namazit të teravisë, ose gjëra të ngjashme që zakonisht i ofrojnë ligjëruesit dhe këshilluesit, gjëra që pa dyshim u bëjnë dobi agjëruesve dhe u sjellin mirësi dhe bereqete, por kam zgjedhur që të flas për një studim mjaft të rëndësishëm, sepse është prej bazave të shariatit të shëndërritshëm, kurse ka të bëjë me sqarimin e rëndësisë së Sunnetit në ligjin Islam.

Detyra e Sunnetit sipas Kur'anit

Ju të gjithë e dini se All-llahu, tebareke ve teala, e ka zgjedhur Muhammedin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që të jet peygamber dhe e ka veçuar me shpallje, ia ka zbritur Kur'anin Fisnik dhe mes tjerash e ka urdhëruar edhe që tua sqarojë njerëzve, duke thënë:

"(I patëm dërguar) Me argumente e me libra të shenjtë. Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është

shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur'anin)". (En-Nahl: 44).

Sipas meje ky sqarim dhe shpjegim i përmendur në këtë ajet fisnik është dy lloje:

Një: Shpjegim i fjalëve dhe renditjes, e kjo është kumtimi i Kur'anit, mosfshehja e tij dhe ofrimi ummetit siç ia ka shpallur All-llahu zemrës së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Kjo domethënie është për qëllim në ajetin: "O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revalatën-risalen). All-llahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon". (El-Maide: 67).

Aisheja, radijall-llahu anha, ka thënë: "Kush ju flet se Muhammedi ka fshehur diç prej asaj që është urdhëruar ta kumtojë, ai ka bërë shpifje të madhe mbi All-llahun, e pastaj e lexoi ajetin e lartpërmendur". (Bu-

harian dhe Muslimi).

Kurse në transmetimin e Muslimit qëndron: "Po të kishte fshehur Pejgamberi, diçka nga ajo që është urdhëruar ta kumtojë, do të kishte fshehur ajetin: "(Përkujto) Kur i the atij që All-llahu e kishte shpërblyer (me besim) e edhe ti i pate bërë mirë: "Mbaje bashkëshorten tënde dhe ki frikë nga All-llahu!", e ti e mbaje fshehtë në veten tënde atë që All-llahu do ta zbulojë dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t'i frikësohesh All-llahut. ...". (El-Ahzab: 37).

Dy: Sqarimi i domethënies së fjalëve ose fjalive, ose ajetit, për të cilin sqarim ka nevojë ummeti. Kjo më së shumti ndodh me ajetet e përgjithshme dhe globale, andaj vjen sunneti dhe i sqaron gjërat e përgjithshme, i veçon ato dhe i përkufizon. Kjo bëhet me fjalët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, por edhe me veprat dhe konfirmimet e tija.

Përktheu: Bekir Halimi
Muhammed Nasiruddin Albani
18.2.2005

20. Heshtja dhe ruajtja e gjuhës

Transmeton Ebu Hurejra, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush beson Allahun dhe Ditën e Ahiretit le të thotë fjalë të mira ose le të hesht. Kush beson Allahun dhe Ditën e Ahiretit le të nderoj fqin. Kush beson Allahun dhe Ditën e Ahiretit le të nderoj mikun".

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi".

Poashu: "Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm".

Fjala "kush beson Allahun dhe Ditën e Ahiretit" e ka kuptimin: kush beson me besim të plotë që të shpëton prej dënimit të Allahut dhe që të shpien kah kënaqësia e Tij. "Ose të thotë fjalë të mira ose të hesht" sepse ai i cili beson me besim të vërtetë frikohet prej kërcënimit të Allahut, shpreson shpërblimin e Tij, mundohet të zbatojë urdhërat, të largohet prej ndalesave dhe ajo që është më e rëndësishmja kontrollimi i gjymtyrëve për të cilat kujdeset dhe për të cilat do të pyetet, Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Të dëgjuarit, të pamët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi". Dhe:

"Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm". , kurse rrëshqitet e gjuhës janë të shumta...

Disa dijetarë rreth kuptimit të hadithit kanë thënë: kur njeriu dëshiron të flet, mendon: nëse ajo që do të flet është mirësi e sigurt që shpërblehet atëherë le të flet në të kundërtën duhet të heshtë pa marrë parasysh a i bëhet e qartë se ajo fjalë është e ndaluar (haram) e urryer (mekruh) apo as e lavdëruar as e urretjur (mubah). Në bazë të kësaj përfundojmë se fjalët që vlerësohen si "mubah" preferohet që të lihen e të mos shprehen nga frika që mos të tërheq fjala fjalën e të flet fjalë të urryera ose të ndaluara, sepse kjo gjë ka gjasa të mëdha të ndodhë, "Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm".

Neveviu thotë: "Ky hadith qartë na mëson se njeriu nuk duhet të flet vetëm nëse fjala është e mirë, mirësia e të cilës është e qartë, e nëse dyshon në mirësinë e saj atëherë hesht.

Fjala "le të nderoj fqin", "le të nderoj mikun" na jep të kuptojmë obligimin ndaj fqiu dhe mikut si dhe bamirësinë ndaj tyre. I mençuri obligohet që vazhdimisht të heshtë derisa të folurit nuk është obligativ. Sa shumë janë ata që pendohen pasi që flasin, kurse të paktë janë ata që pendohen pse kanë heshtur. Njerëzit më të dëshpruar dhe më të sprovuar janë ata që kanë gjuhë llafazane dhe zemër të vulosur. Gjuha ka dhjetë karakteristika dhe çdo i mençur obligohet që t'i mëson ato e të vëndojë çdo karakteristikë në vendin e saj: ajo është mjet për sqarim, dëshmitare që lajmëron atë gjë që gjindet në zemër, flet për të kthyer përgjigjen, ndërmjetëson për të arritur nevojat, përshkruese për t'u njohur gjërat, nëpërmjet saj largohet zemërimi, sjellet dashuria, është relaksuese dhe pastruese për zemrat dhe krenare me të

cilën largon brengat.

Kurse: heshtja është shpëtim, siç është thënë: “Kush heshtë shpëton”.

Transmeton Ebu Hatimi se K'ab ibën Maliku ka thënë: Shpëtimi është dhjetë pjesë, nëntë prej tyre janë në heshtje.

Gjithashtu transmetohet se Abdullah ibën Mes'udi, radijallahu anhu, ka thënë: Pasha Atë pos të Cilit nuk ka zot tjetër, ajo që më tepër meriton burgim të gjatë është gjuha.

Thuhet se pasi që Junusi, alejhi selam, doli prej barkut të balenës shoqëronte heshtjen dhe pasi që u pyet për këtë, tha: të folurit më çoi në barkun e balenës.

Malik ibën Dinari ka thënë: Sikur ne t'i shkruanim fjalët tona do ta pakësonim të folurit.

Imam Shafiu, rahimehull-llah, ka thënë: Nëse ndonjëri prej jush dëshiron të flet atëherë lë të mendojë: nëse e sheh se ka dobi flet e nëse dyshon nuk flet derisa të bindet se dobia qëndron në të folurit.

Tregohet se janë mbledhur katër njerëz të urtë dhe njëri prej tyre tha: Më tepër kam mundësi të kundërshtoj atë që s'e kam thënë se sa atë që e kam thënë. Tjetri tha: Të pendohem pse nuk kam folur është më e dashur për mua se sa të pendohem nga ajo që e kam thënë. I treti tha: Kur e flas një fjalë ajo më zotëron kurse kur nuk e flas atë e zotëroj unë. I katërti tha: habitem me atë që flet një fjalë e cila nëse i përshkruhet atij që e ka thënë i bën dëm e nëse nuk i përshkruhet nuk i bën dobi.

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)